



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 258 Akti

Nr. 234 Vendimi
Tiranë, më 4.2.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesues
Brunilda Bekteshi	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, në datën 31.1.2020, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Miliana Muça**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, përfaqësuar personalisht.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

“**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Miliana Muça, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

3. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 18.1.2019, të trupit gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit të sipërpërmendura, hartuar nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues, komisionere Firdes Shuli. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

4. Në datën 23.1.2019, subjekti i rivlerësimit, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 23.2.2020, Komisioni me vendimin nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Miliana Muça për të tria kriteret e rivlerësimit: kriterin e pasurisë, kriterin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e saj brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Në datën 23.1.2020, subjektit të rivlerësimit iu njoftuan rezultatet e hetimit dhe në datën 28.1.2020 subjekti dërgoi prapësimet në mënyrë elektronike.

7. Në datën 29.1.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 3 vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Miliana Muça, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr.

84/2016. Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 31.1.2020, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

8. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit znj. Miliana Muça, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

9. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Miliana Muça. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 31.1.2020, për të rifilluar në datën 4.2.2020, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

10. Znj. Miliana Muça ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (ç) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

* Komisioni bën pjesë integrale të këtij vendimi, analizën financiare për vitet 2003 -2016, të përgatitur nga Njësia e Shërbimit Ligjor, treguesit dhe të dhënat e të cilës pasqyrohen në tabelën përkatëse.

I. MBI KRITERIN E PASURISË

Në lidhje me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit sipas deklaratës “Vetting”, nga hetimi ka rezultuar si vijon:

1. Në lidhje me pasurinë, tokë bujqësore të ndodhur në fshatin Maminas, Njësia Administrative Maminas, Bashkia Shijak, referuar aktit të marrjes së tokës në pronësi me nr. regjistri (***), datë 9.8.1994, në emër të kryefamiljarit Sh. M. . Sipas këtij akti familja është trajtuar me një sip. 11.122 m² tokë gjithsej, nga kjo sip. 10.252 m² është tokë bujqësore.

1.1 Subjekti lidhur me këtë pasuri, po në deklaratën “Vetting”, ka deklaruar se:

“a. Referuar dokumentit certifikatë e përbërjes familjare në datën 1.8.1991 në familje kanë qenë 5 anëtare.

b. Toka bujqësore figuron e regjistruar në emër të kryefamiljarit Sh. M. .

*c. Në lidhje me origjinën e bashkëpronësisë (pjesa takuese në bazë të normës për frymë) rezulton se me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. (***), datë 9.8.1994, familja me kryefamiljar Sh. H. M. është trajtuar me tokë bujqësore në masën 11.122 m², ku norma për frymë ka qenë 2.245 m², sipas vërtetimit, datë 24.10.2016, të Njesisë Administrative Maminas, Bashkia Shijak në Durrës dhe sipas certifikatës së përbërjes familjare nr. (***), datë 21.10.2016, për përbërjen më datë 1.8.1991. Pjesa takuese 1/5 e pasurisë të pandarë në bashkëpronësi (pjesa ideale).”*

1.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹.

1.3 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

1.4 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se kjo pasuri është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2003, me përshkrim: *“1/5 pjesa zotëruese, sipas ligjit nr. 7501, datë 31.7.1991, “Për tokën”, regjistruar në emër të kryefamiljarit”.*

1.5 Po ashtu, kjo pasuri është deklaruar në deklaratën “Vetting”, me përshkrimin: *“Tokë bujqësore në fshatin Maminas, Njësia Administrative Maminas, Bashkia Shijak, referuar dokumentit, akti i marrjes së tokës bujqësore, me nr. regjistri (***), datë 9.8.1994, gjithësej 11 122 m² tokë, nga kjo 10252 m² tokë bujqësore, në pjesë takuese 1/5”.*

1.6 Sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi² nr. (***), regjistri, datë 9.8.1994, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit, z. Sh. M., ka përfituar tokë në pronësi sipas ligjit nr. 7501/1991“Për tokën”.

1.7 Bazuar në kërkesat e këtij ligji dhe aktet nënligjore, ku përfitues janë të gjithë anëtarët e trungut familjar sipas përbërjes familjare datë 1 gusht 1991, Komisioni ka verifikuar edhe certifikatën e Zyrës së Gjendjes Civile Maminas, lëshuar në datën 21.10.2016, nga ku pasqyrohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtin trung familjar në datën 1.8.1991.

¹ Akti i marrjes së tokës në përdorim nr. (***), datë 9.8.1994; vërtetim, datë 24.10.2016, i Njesisë Administrative Maminas, Bashkia Shijak; certifikatë familjare nr. (***), datë 21.10.2016.

² Referojuni aneksit 4/1, në dosjen e ILDKPKI-së.

1.8 Sipas vërtetimit,³ datë 24.10.2018, të Bashkisë Shijak, Njësia Administrative Maminas, provë e administruar në dosjen e hetimit administrativ, rezulton se subjekti i rivlerësimit është trajtuar me tokë bujqësore, me sip. 2245 m², sipas ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”.

1.9 Njëkohësisht, Komisioni ka konstatuar se edhe sipas informacionit “kthim përgjigje”⁴ nr. (***) prot., datë 18.3.2019, të ZVRPP-së Durrës, rezulton se familja bujqësore e z. Sh. M. është trajtuar me tokë bujqësore sipas kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 7501/1991, dhe se subjekti në datën 1.8.1991 ka qenë pjesë përbërëse e kësaj familje.

Analiza e provave dhe e fakteve

1.10 Në analizë të deklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar dhe të pasqyruar më sipër në mënyrë kronologjike, për këtë pasuri, trupi gjykues ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi mënyrën e fitimit të pasurisë në bashkëpronësi me familjarët e saj të origjinës, në pjesë takuese të barabarta, si pasuri e fituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, që në deklarin periodik për herë të parë, në deklaratën “Vetting”, në pyetësorë përgjatë hetimit administrativ, si dhe ka provuar me dokumente shkresore, vërtetësinë e deklarimeve. Bazuar në aktet e administruara, trupi gjykues, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, sipas gjendjes familjare të datës 1.8.1991 ka qenë pjesëtare e familjes bujqësore respektive dhe se familja e saj ka përfituar tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, regjistruar në ZVRPP-në, me statusin “familje bujqësore”. Bazuar në nenin 222 të Kodit Civil, anëtarët e familjes tërheqin të drejta reale pronësore mbi pasurinë “tokë arë” dhe sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimin ligjor të deklarimit të të drejtave reale mbi këtë pasuri, sipas Kodit Civil.

- ✓ Në konkluzion, për këtë pasuri, në lidhje me vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me kërkesat e ligjit të cituar, trupit gjykues nuk i rezultuan problematika dhe për pasojë subjekti ka kryer deklarim të mjaftueshëm në lidhje me këtë pasuri dhe me pjesën takuese të saj.

2. Në lidhje me pasurinë, automjet tip “Benz Mercedes Classik 200D” (e shitur para këtij deklarimi), prodhim i vitit 1993, me targa (***) (pas ndryshimit të sistemit të targave me targë të re (***)), me nr. shasie (***), blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. (***), datë 21.8.2005, në vlerën totale 551.329 lekë, nga ku vlera 250.000 lekë është çmimi i paguar për blerjen e automjetit shitësit A. B. sipas kontratës për shitblerje automjeti dhe vlera prej 301.329 lekësh, sipas mandatit, datë 22.7.2005, për pagimin e doganës dhe të TVSH-së, paguar në fillim nga shitësi dhe mbuluar nga ana e blerësit, në 1/2 pjesë të pandarë në bashkëpronësi me bashkëshortin.

Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga me veprimet, si më poshtë:

“a. Pakësim i depozitës bankare të kursimit pranë Raiffeisen Bank, me burim të ardhurat nga paga të dy bashkëshortëve (e cila në datën 31.12.2003 ka qenë në shumën 312.644 lekë

³ Referojuni aneksit 4/1, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴ Referojuni dokumentacionit të administruar në pyetësorin nr. 2, datë 21.10.2019, në dosjen e Komisionit.

dhe në datën 31.12.2004 ka qenë në shumën 700.000 lekë), në datën 22.8.2005 është pakësuar për blerjen e automjetit me shumën 200.000 lekë, llogari e cila ka mbetur në vijim gjendje në shumën 520.000 lekë.

b. Tërheqje e shumës 337.431 lekë nga depozita bankare pranë Raiffeisen Bank, llogari e cila në këtë datë është mbyllur.

c. Një pjesë nga shuma e tërhequr 180.000 lekë me burim overdraft pranë Raiffeisen Bank, tërheqje e kryer në datën 22.8.2005 me nr. reference (***), e vërtetuar edhe me dokumentin “nxjerrje llogarie” e printuar në datën 14.10.2016.

Ky mjet është shitur me kontratën e shitblerjes nr. (***), datë 23.3.2016, me çmimin 200.000 lekë.”

2.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁵.

2.2 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRr-ja.

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

2.3 Nga analizimi dhe verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ ka rezultuar se kjo pasuri është deklaruar:

2.3.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 me përshkrimin: “*makinë benz, viti 1994, targa (***)*, nr. shasie (***) e regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit, z. N. R. . Vlera: 600.000 lekë. Pjesa zotëruese: ½ (pasuri bashkëshortore)”.

2.3.2 Pasuria konfirmohet me kontratë shitblerje automjeti⁶ Nr. (***), datë 21.8.2005, me palë shitëse shtetasin A. B. dhe palë blerëse shtetasin N. R. . Në kontratë vlera e shitjes së automjetit është në shumën 250.000 lekë, shumë kjo sipas parashikimit kontraktor është marrë nga shitësi. Bashkangjitur kontratës është depozituar edhe mandatarkëtimi për zhdoganimin e këtij mjeti në vlerën 301.329 lekë. Mandatarkëtimi mban datën 22.7.2005.

2.3.3 Nga korrespondenca e mbajtur nga Komisioni me DPSHTRr-në, kjo e fundit, me shkresën nr. (***), datë 20.9.2019, ka informuar se nga verifikimi rezulton se shtetasi N. Dh. R. ka pasur të regjistruar automjetin me targa aktuale (***).

2.3.4 Nga analizimi i dokumentacionit shoqërues rezulton se ky automjet është blerë nga shtetasi A. B. në vlerën 2400 euro ose 300.000 lekë dhe është zhdoganuar në datën 22.7.2005 me deklaratën nr. (***). Mbi këtë vlerë janë aplikuar taksat përkatëse dhe shuma e paguar për zhdoganimin rezulton në vlerën 301.028 lekë.

2.3.5 Subjekti në deklaratën “Vetting” ka deklaruar burimin e krijimit të shumës së paguar për këtë automjet.

⁵ Kontratë shitblerje automjeti nr. (***), rep., nr. (***), kol., datë 21.8.2005; Mandat arkëtimi nr. (***), datë 22.7.2005 në BKT; Kontratë shitblerje nr. (***), rep., nr. (***), datë 23.3.2016; Vërtetim datë 20.10.2016 dhe datë 20.1.2017 nga Raiffeisen Bank; Nxjerrje llogarie nga Banka Raiffeisen datë 14.10.2016. (Aneks nr.4/2 në dosjen e ILDKPKI-së)

⁶ Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

- a) Pakësim i depozitës bankare të kursimit në “Raiffeisen Bank”, me burim të ardhurat nga paga e dy bashkëshortëve e cila në datën 31.12.2003 ka qenë në shumën 312.644 lekë dhe në datën 31.12.2004 ka qenë në shumën 700.000 lekë. Në datën 22.8.2005 kjo depozitë është pakësuar për blerjen e automjetit me 200.000 lekë, llogari e cila ka mbetur në vijim gjendje në vlerën prej 520.000 lekësh.
- b) Tërheqje e shumës 337.431 lekë nga depozita bankare në “Raiffeisen Bank”, llogari e cila në këtë datë është mbyllur.
- c) Një pjesë nga shuma e tërhequr 180.000 lekë me burim *overdraft* në “Raiffeisen Bank”, tërheqje e kryer në datën 22.8.2005, me nr. reference (***)

2.3.6 Në datën 23.8.2005 është tërhequr shuma 337.431,38 lekë dhe është mbyllur depozita me Nr. (***) në emër të z. N. R., në “Raiffeisen Bank”⁷.

2.3.7 Në datën 22.8.2005 janë tërhequr shumat 180.000 lekë dhe 200.000 lekë nga llogaria rrjedhëse nr. (***)⁸, në emër të z. N. R., në “Raiffeisen Bank”.

Analiza e provave dhe fakteve

2.4 Trupi gjykues, në analizë të provave dhe fakteve të konstatuara përgjatë hetimit administrativ lidhur me ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie (aktualisht pasuri e shitur), arsyeton si vijon:

2.4.1 Në nivelin e provueshmërisë së krijimit të ligjshëm të kësaj pasurie kanë ndikuar disa fakte të konstatuara dhe të provuara gjatë hetimit administrativ, si:

- i. plotësimi i saktë i deklaratës periodike në kohën kur ka ndodhur veprimi i shitblerjes së automjetit;
- ii. plotësimi i saktë i deklaratës “Vetting”, si deklarata që ligjërisht bazuar në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar, kanë kërkuar plotësi, saktësi dhe vërtetësi të të gjithë pasurive përfshirë dhe burimin e krijimit të tyre;
- iii. deklaratimet e subjektit në pyetësorë përgjatë hetimit administrativ; si dhe
- iv. të gjitha provat e depozituara dhe të administruara.

2.4.2 Në arsyetim të fakteve të lartpërmendura është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, njëkohësisht edhe bashkëshorti i saj me cilësinë e blerësit në kontratën e shitblerjes së automjetit kanë deklaruar këtë pasuri në kohë reale, në vitin e blerjes, pra, në deklaratën periodike vjetore për vitin 2005, si dhe kanë deklaruar të njëjtat veprime bankare, të shërbyera si burim krijimi për këtë pasuri, si në vitin 2005 dhe po ashtu edhe në deklaratën “Vetting”.

2.4.3 Trupi gjykues, nga verifikimi i kryerjes së veprimeve bankare nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka konstatuar se ka tërhequr përkatësisht, siç edhe ka deklaruar ekzaktësisht në deklaratën për vitin 2005 dhe në deklaratën “Vetting”, shumën 200.000 lekë nga llogaria rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, shumën 180.000 lekë nga *overdraft* në datën 22.8.2005, si dhe shumën 337.431,38 lekë po në këtë bankë në datën 23.8.2005.

⁷ Dokumentacion i depozituar nga subjekti në pyetësorin nr. 2, datë 21.10.2019.

⁸ Shkresë nr. (***) prot., datë 17.9.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

2.4.4 Duke qenë se palët kanë shprehur vullnetin e tyre në këtë marrëdhënie shitblerje pasurie, shumat e shërbyera, të tërhequra nga sistemi bankar në një hark kohor tepër të shkurtër, konkretisht vetëm një ditë pas nënshkrimit të kontratës nuk cenojnë aspak burimin e ligjshëm të deklaruar për këtë pasuri. Dukshëm është e provueshme se palët kanë qenë tërësisht në mirëbesim ndaj njëra tjetrës dhe në asnjë rast nuk janë identifikuar kundërshti mes tyre.

2.4.5 Afërsia e kryerjes së veprimeve financiare nga momenti i blerjes së automjetit, nga ku rezultojnë shumat e tërhequra përkojnë me çmimin e deklaruar të blerjes, të krijojnë bindjen e vërtetësisë dhe të saktësisë së deklarimit të mjaftueshëm të bërë për këtë pasuri.

2.4.6 Në lidhje me saktësinë e shumës së shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie, nga ku ka rezultuar se në vitin 2005 është deklaruar shuma 600.000 lekë, ndërsa në deklaratën “Vetting” është deklaruar shuma 551.329 lekë, trupi gjykues konsideron faktin se diferenca është e papërfillshme. Gjithashtu, trupi gjykues konsideron faktin që subjekti në vitin 2005 ka deklaruar në mënyrë transparente shumën totale të shpenzuar ku përfshihej edhe zhdoganimi i automjetit.

2.4.7 Trupit gjykues nga hetimi i kryer për llogaritë e sipërcituara, si burim krijimi për këtë pasuri, nga momenti i krijimit deri në mbylljen e tyre apo edhe në lidhje me shumat e tërhequra nga llogaria rrjedhëse, nuk i rezultuan problematika.

2.4.8 Në tërësi të hetimit administrativ për këtë pasuri vlerësohet kujdesi i treguar nga subjekti i rivlerësimit në saktësimin e shumës së shpenzuar për blerjen e automjetit, pikërisht në deklaratën “Vetting”, sikurse është parashikuar dhe kërkohet nga Udhëzimi nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”.

2.4.9 Trupi gjykues ka konstatuar gjithashtu, se nga kryerja e analizës financiare⁹ të vitit 2005, vit kur është kryer investimi në këtë pasuri, subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare gjatë vitit 2005.

2.4.10 Për të gjithë argumentet e paraqitura sa më sipër, të bazuara në fakte e prova:

✓ Trupi gjykues arrin në konkluzion se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të mjaftueshëm në lidhje me krijimin dhe burimin e ligjshëm të kësaj pasurie.

3. Në lidhje me pasurinë, apartament¹⁰ banimi 2+1 me sipërfaqe 98 m², pasuria me nr. (*) , z. k. (***) , vol. (***) , f. (***) , me adresë: Rr. “(***)” , p. (***) , shk. (***) , k. (***) , ap. (***) (sot, Rr. “(***)”) , Korçë, sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. (***) seriali, datë**

⁹ Referojuni analizës financiare për vitin 2005 në tabelën pjesë integrale e këtij vendimi, si dhe për çdo pasuri në vijim referojuni në të njëjtën mënyrë vitit apo viteve përkatëse.

¹⁰ Pasuri e shitur sipas kontratës nr. (***) , datë 9.2.2019, administruar në praktikën nr. (***)prot., datë 18.10.2019, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Korçë, në dosjen e Komisionit.

5.9.2013, shoqëruar me hartën treguese. Vlera: 3.800.000 lekë. Pjesa takuese: 1/2 pjesë e pandarë në bashkëpronësi bashkëshortore.

Në lidhje me burimin e krijimit dhe mënyrën e shlyerjes së këtij apartamenti

3.1 Subjekti, për mënyrën e shlyerjes së apartamentit, ka deklaruar se:

*“- Në aktmarrëveshjen e datës 15.2.2007, nga blerësi N. R. (bashkëshorti i subjektit deklarues Miliana Muça) është parapaguar shuma 1.000.000 lekë, si fillim shuma 500.000, e derdhur për llogari të firmës ndërtuese “K.” sh.p.k., me mandatarkëtimin nr. (***) , datë 15.2.2007, dhe shuma 500.000 lekë e derdhur për llogari të firmës ndërtuese “K.” sh.p.k., me mandatarkëtimin nr. (***) , datë 19.2.2007.*

*- Burimi i shumës prej 1.000.000 lekësh të parapaguara në favor të firmës ndërtuese “K.” sh.p.k., lidhet me: sipas dokumentit “veprim arke, tërheqje cash” të datës 13.2.2007, me nr. reference (***) , është tërhequr nga llogaria me nr. (***) pranë Raiffeisen Bank shuma 500.000 lekë, kursime nga paga. Pjesa tjetër prej 500.000 lekë ka qenë në gjendje cash në shtëpi, kursime nga paga dhe të ardhurat familjare, të deklaruara edhe në deklaratën datë 19.3.2007 për vitin 2006.*

*- Sipas aktmarrëveshjes së datës 15.2.2007, nga blerësi N. R. është parapaguar edhe shuma 800.000 lekë, e derdhur për llogari të firmës ndërtuese “K.”sh.p.k., me mandatarkëtim nr. (***) , datë 18.2.2008.*

*- Kjo shumë buron nga kontrata e huas nr. (***) , datë 14.2.2008, lidhur ndërmjet huamarrësit N. R. dhe huadhënësit Sh. M. (babai i subjektit të rivlerësimit, z. Miliana Muça), kontratë në bazë të së cilës jepet si hua shuma 800.000 lekë, e cila do të kthehet (shlyhet) duke paguar çdo vit më datë 15 shkurt një shumë prej 100.000 lekësh, maksimumi me afat shlyerje për 10 vjet.*

*- Për shlyerjen e shumës së mbetur prej 2.000.000 lekësh, si pjesë e çmimit 3.800.000 për blerjen e këtij apartamenti, është marrë një kredi bankare te BKT, sipas kontratës së kredisë bankare nr. (***) , datë 6.3.2007, të lidhur ndërmjet kredimarrësit N. R. dhe kredihënësit Bankës Kombëtare Tregtare (BKT).”*

3.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentet përkatëse¹¹.

3.3 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e institucioneve.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

3.4 Kjo pasuri është deklaruar:

¹¹ Certifikatë pronësie nr. (***) , datë 5.9.2013; aktmarrëveshje shitje banese datë 15.2.2007; mandatarkëtimi nr. (***) , datë 15.2.2007; mandatarkëtimi nr. (***) , datë 15.2.2007; mandat tërheqje nga “Raiffeisen Bank”, datë 13.2.2007; mandatarkëtimi nr. (***) , datë 17.8.2007; kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme me nr. (***) , datë 3.9.2008; kontratë huaje nr. (***) , datë 14.2.2008; mandatarkëtimi nr. (***) , datë 18.2.2008; vërtetim datë 24.10.2016, nga “Raiffesien Bank”; nxjerrje llogarie të shtetasit Sh. M. nga “Raiffeisen Bank” për periudhën 4.8.2005 – 24.10.2016; kërkesë për transaksion datë 15.3.2007, BKT; vërtetim nr. (***) prot., datë 14.10.2016, i lëshuar nga BKT; kontratë huadhënieje nr. (***) , datë 14.9.2011; deklaratë noteriale nr. (***) , datë 24.9.2012; vërtetimin nr. (***) prot., datë 24.10.2016; nxjerrje llogarie e shtetasit H. H., datë 25.10.2016, nga “Banka e Tiranës”. (Aneks nr. 4/3, në dosjen e ILDKPKI-së).

3.4.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 me përshkrimin “blerje apartament banimi Korçë, sip. 98 m², kontrata nr. (***) , datë 3.9.2008”. Vlera e apartamentit: 3.800.000 lekë. Burimi i krijimit: 2.000.000 lekë kredi, 500.000 lekë depozitë, 500.000 lekë kursime, viti 2006 dhe 800.000 lekë kontratë huaje. Pjesa takuese: ½ në pasuri bashkëshortore.

3.4.2 Kjo pasuri konfirmohet me kontratën e shitblerjes¹² nr. (***) , datë 3.9.2008, me palë shitëse shoqëria “K.” sh.p.k., Korçë, dhe palë blerëse N. R. . Vlera e apartamentit: 3.800.000 lekë, shumë të cilën pala blerëse e ka paguar në favor të palës shitëse jashtë zyrës noteriale. Sipërfaqja e apartamentit: 98 m².

3.4.3 UKT-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 24.9.2019, nuk konfirmon kontratë në emër të subjektit apo familjarëve të saj. Subjekti është pyetur¹³ në lidhje me kontratën e ujësjellësit për këtë pasuri, si dhe pagesat përkatëse, për të cilën ka vënë në dispozicion shkresën e datës 11.11.2019, ku bashkëshorti i subjektit konfirmohet si titullar i kontratës me nr. klienti (***) , në adresën përkatëse të kësaj pasurie, prej vitit 2007 deri në vitin 2019. Gjithashtu, ky institucion ka konfirmuar se klienti i ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj kësaj shoqërie.

3.4.4 OSHEE-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 3.10.2019, konfirmon në emër të shtetasit N. R. disa kontrata furnizimi në instancën Korçë, por pa identifikuar atësinë e shtetasve titullarë të kontratave. Subjekti është pyetur¹⁴ në lidhje me kontratën e OSHEE-së për këtë pasuri dhe pagesat përkatëse, për të cilën ka vënë në dispozicion librezën përkatëse, si dhe shkresën nr. (***) prot., datë 8.11.2019, me të cilën bashkëshorti i subjektit konfirmohet si titullar i një kontrate në instancën Korçë, deri në datën 19.2.2019, dhe më tej, për shkak të shitjes së kësaj pasurie, fakt i vërtetuar edhe nga hetimi administrativ, titullar i kësaj kontrate rezulton të jetë shtetasi A. Z. .

3.4.5 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, me shkresën nr. (***) prot., datë 18.10.2019, ka konfirmuar se në emër të shtetasit N. R., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka pasur në pronësi pasurinë me nr. (***) , z. k. (***) , vol. (***) f. (***) . Lloji i pasurisë është apartament me sip. totale 98 m².

3.4.6 Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit për këtë pasuri rezulton se në datën 15.2.2007 është nënshkruar aktmarrëveshja shitje banese ndërmjet shoqërisë së ndërtimit “K.” sh.p.k., dhe blerësit N. R. . Çmimi i shitjes së banesës është në vlerën 3.800.000 lekë.

3.5 Mënyra e pagesës sipas kësaj aktmarrëveshjeje ka rezultuar si më poshtë:

3.5.1 Pagesa e parë do të jetë në vlerën 1.000.000 lekë, ose 26.3 % e çmimit të banesës. Për shlyerje të plotë të banesës blerësit i nevojitet edhe vlera prej 2.800.000 lekësh, të cilën do ta shlyejë (nuk është përcaktuar data).

3.5.2 Pagesat¹⁵ për këtë apartament janë kryer në datat e mëposhtme:

¹² Aneks 4/3, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹³ Pyetësi nr. 4, datë 6.11.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁴ Pyetësi nr. 4, datë 6.11.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Aneks 4/3, në dosjen e ILDKPKI-së.

Data	Shuma e paguar	Dokumentacioni
15.2.2007	500.000	mandatarkëtim
19.2.2007	500.000	mandatarkëtim
17.3.2007	19.600	mandatarkëtim
15.3.2007	1.980.400	urdhërshirim BKT
18.2.2008	800.000	mandatarkëtim
Total	3.800.000	

3.6 Komisionit, nga verifikimi i dokumentacionit, i ka rezultuar se subjekti nuk e ka deklaruar aktmarrëveshjen dhe pagesat e kryera në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, por ka deklaruar kontratën e shitjes në deklaratën e vitit 2008.

3.7 Lidhur me këtë konstatim, subjektit iu kërkua¹⁶ të japë shpjegime shtesë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

3.8 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka qartësuar se e konsideron të drejtë konstatimin e Komisionit lidhur me mosdeklarimin e aktmarrëveshjes në vitin 2007 për blerjen e apartamentit dhe pagesat e kryera në shumën 3.000.000 lekë, por se në deklarimin nëpërmjet deklaratës periodike të vitit 2007, të dorëzuar në ILDKPKI, ka reflektuar kredinë e marrë për blerjen e apartamentit.

3.9 Subjekti, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, është shprehur se lidhur me mosdeklarimin e aktmarrëveshjes së datës 15.2.2007 me shoqërinë e ndërtimit “K,” sh.p.k. (f. 10-11 e raportit), së bashku me bashkëshortin kishin vlerësuar se deklarimi i blerjes së apartamentit do të kryhej në bazë të kontratës së rregullt të shitjes, e cila do të lidhej në vijim, pasi akti fillestar “aktmarrëveshje shitje banese pa të drejtë pronësie” i datës 15.2.2017, nuk ishte akt noterial. Kontrata e shitjes së apartamentit është me nr. (***), datë 3.9.2008. Subjekti është shprehur se asnjëri prej tyre si bashkëshortë, nuk ka pasur si qëllim ta fshehë këtë aktmarrëveshje dhe pagesat e kryera në vitin 2007, pasi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 në kolonën “ndryshimet e interesave private...” është deklaruar: “*Kredi nga BKT me afat pesëvjeçar për blerje shtëpie*” (citim f. 3 e deklaratës), sikurse edhe kështet e kredisë së paguara për muajt mars 2007 - dhjetor 2007. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 është deklaruar kontrata noteriale e shitblerjes, si dhe mënyra, kështet dhe koha e shlyerjes, në total të çmimit prej 3.800.000 (tre milionë e tetëqind mijë) lekësh.

3.10 Gjithashtu, subjekti ka reflektuar edhe një fakt tjetër në shpjegimet e saj, se bashkëshorti, si subjekt deklarimi, është ftuar të japë shpjegime në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike” dhe se referuar procesverbalit datë 17.12.2018, të emërtuar “mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurisë”, rezulton se është pyetur për shpjegime lidhur me deklaratën vjetore të vitit 2007. Konkretisht, lidhur me objektin e

¹⁶ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

kredisë së deklaruar dhe çmimin e blerjes së apartamentit, ka saktësuar duke dorëzuar bashkëngjitur dhe dokumentacion, sikurse është aktmarrëveshja me kompaninë e ndërtimit dhe dokumentacion nga “Raiffeisen Bank” për kalimin e vlerës së kredisë të shoqëria e ndërtimit, si dhe vlerës prej 500.000 lekësh, të tërhequr në “Raiffeisen Bank”. Referuar procesverbalit, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se: “...me aktmarrëveshjen datë 15.2.2007 kam porositur apartament banimi, sip. 103 m² me adresë... me firmën ndërtuese ‘K.’ sh.p.k., me vlerë 3.800.000 lekë. Kam likuiduar 3.000.000 lekë dhe kam detyrim të palëkundura deri në datën 31.12.2017, 800.000 lekë. Bashkëlidhur ka dorëzuar për ILDKPKI-në fotokopje të aktmarrëveshjes, kontratë shitjeje, dokument nga veprimet në ‘Raiffeisen Bank’, të vitit 2007. Burimi i shumës 3.000.000 lekë rrjedh nga tërheqja e depozitës në ‘Raiffeisen Bank’, në shumën 500.000 lekë dhe kredi në BKT në shumën 20.500 CRF ose rreth 2.000.000 lekë...”.

3.11 Në këtë mënyrë deklarimi është plotësuar me shpjegime dhe dokumentacion, sipas procesverbalit të mbajtur në ambientet e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).

3.12 Nëpërmjet procesverbalit është dhënë informacion edhe për likuidimin e shumës 3.000.000 lekë gjatë vitit 2007, nga të cilat shuma 500.000 mijë lekë është marrë nga tërheqja e depozitës në “Raiffeisen Bank” dhe shuma 2.000.000 është marrë nga kredia. Pagesa e mbetur në shumën 500.000 lekë është nga kursimet *cash*.

3.13 Deklarimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga bashkëshorti i subjektit njëkohësisht sqaron edhe situatën në deklarin periodik vjetor për vitin 2007 nga subjekti, pasi deklarinet kanë qenë identike për sa i përket situatës së sipërtrajtuar.

3.14 Subjekti ka sqaruar se në gjykimin e saj, dhënia e sqarimeve, e shoqëruar me dorëzimin e dokumentacionit, reflektuar sipas procesverbalit “mbi shpjegimet e subjektit të deklarin të pasurisë” datë 17.12.2008, nuk konsiderohet se jemi në kushtet e mosdeklarin. Gjithashtu, po me deklaratën “Vetting” janë deklaruar saktësisht (të shoqëruar dhe me dokumentacionin përkatës) transaksionet e kryera në vitin 2007, për sa i përket likuidimit të shumës 3.000.000 lekë.

3.15 Subjekti ka depozituar procesverbalin “mbi shpjegimet e subjektit të deklarin të pasurisë” datë 17.12.2008.

Analiza e provave dhe fakteve

3.16 Trupi gjykues, në analizë të deklarinëve të subjektit dhe provave të administruara, konstaton se pasaktësia e pasqyruar në deklaratën për vitin 2007, referuar mosdeklarin të aktmarrëveshjes datë 15.2.2007, të realizuar me firmën ndërtuese “K.”, sh.p.k., me vlerë 3.800.000 lekë, ku subjekti kishte porositur apartament banimi (me sip. 103 m²), objekt i hetimit administrativ, nuk le vend për deklarin të pamjaftueshëm dhe as nuk merr peshë në analizimin në tërësi të kësaj çështjeje për disa arsye të argumentuara në vijim.

3.17 Duke e parë më gjerë natyrën e kësaj pasaktësie, në kompleksitet dhe të familjarizuar me elemente të tjera, trupi gjykues vëren se vërtetë subjekti nga njëra anë nuk e ka deklaruar

aktmarrëveshjen, por nga ana tjetër, në të njëjtën deklaratë, atë për vitin 2007, ka deklaruar kredinë e marrë, qëllimin e përdorimit të saj, blerje shtëpie, deklarin rregullisht të shlyerjes së kësteve të kredisë dhe që në tërësi konstatohet se deklarimi është në koherencë të plotë me veprimin e kryer, pra, me nënshkrimin e marrëveshjes.

3.18 Duke ndjekur në mënyrë kronologjike veprimet e subjektit, konkretisht kalimin e kredisë për llogari të firmës ndërtuese po në vitin 2007 me transaksion bankar me përshkrimin “këst për blerje apartamenti”, atëherë mosdeklarimi i aktmarrëveshjes merr vlerën e një pasaktësie në deklaratën periodike.

3.19 Gjithashtu, një provë tjetër që bën të pandikueshëm mosdeklarimin e aktmarrëveshjes është edhe rrethana e re e prezantuar në prapësime nga subjekti i rivlerësimit, fakti që bashkëshorti i subjektit është thirrur dhe pyetur në ILDKPKI në dhjetor të vitit 2008, nga ku është mbajtur edhe procesverbali përkatës, ku, ndër të tjera, ka rezultuar se është pyetur në lidhje me këtë pasuri, për të cilën ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe ka shpjeguar të njëjtat rrethana dhe veprimeve për fitimin e kësaj pasurie, si dhe për burimin e krijimit të saj, sikurse ka deklaruar ekzaktësisht edhe në deklaratën “Vetting”.

3.20 Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerëson në favor të subjektit të rivlerësimit edhe kohën e afërt të formalizimit të kontratës së shitjes në vitin 2008, nga ajo e nënshkrimit të aktmarrëveshjes në vitin 2007, thjesht dhe vetëm një vit pas marrjes së kredisë, kohë kur subjekti ka deklaruar me saktësi blerjen dhe burimin e krijimit të pasurisë në mënyrë identike, sikurse ka deklaruar në ILDKPKI dhe në deklaratën “Vetting”.

3.21 Trupi gjykues konstaton mjaftueshëm përputhje deklarimesh, rakordime provash dhe veprime financiare të kryera, të cilat krijojnë bindjen e plotë se mosdeklarimi i aktmarrëveshjes mbetet një pasaktësi në deklaratën periodike, që nuk merr vlerë në tërësi të kësaj vendimmarrjeje.

3.22 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se:

- ✓ Të gjithë faktorët e analizuar për mjaftueshmërinë e deklarimeve mbi këtë pasuri, si deklarimet e subjektit dhe të bashkëshortit, të cilët rezultuan se kanë mbajtur një linjë përgjatë gjithë kohës, prej vitit 2008 e në vijim, përputhshmëritë e deklarimeve për burimin e krijimit të kësaj pasurie (sikurse qartësohet në vijim të kësaj vendimmarrjeje), me dokumentet bankare dhe veprimet financiare të kryera me qëllim blerjen e pasurisë, kursimet e deklaruara në fund të vitit 2006, të provuara tërësisht si të munduara për t’u krijuar, sipas analizës financiare janë veprime që konkurrojnë në raport me konstatimin e mosdeklarimit të aktmarrëveshjes në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007.

3.23 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

3.23.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën për vitin 2008 si burim krijimi për këtë pasuri:

- a) 2.000.000 lekë kredi;
- b) 500.000 lekë depozitë;
- c) 500.000 lekë kursime, viti 2006;

d) 800.000 lekë kontratë huaje.

Komisioni hetoi mbi çdo burim krijimi të kësaj pasurie, për të parë ligjshmërinë e tyre, si dhe mundësinë financiare të subjektit.

3.23.2 Në lidhje me kredinë në vlerën 2.000.000 lekë

Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se BKT-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 1.10.2019, ka konfirmuar kredinë e marrë nga shtetasi N. R. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit). Për këtë kredi është lidhur kontratë kredie nr. (***), datë 6.3.2007. Shuma e kredisë pasqyrohet në vlerën 26.000 CHF (franga zvicerane), duke u përcaktuar edhe qëllimi, blerje apartamenti. Për këtë kredi është nënshkruar edhe kontrata e hipotekimit nr. (***), datë 6.3.2007, ku hipotekues janë shtetasit R. dhe E. R. . Kjo kredi është siguruar me pasurinë *“apartament me sip. 62.9 m², me nr. pasurie (***) , e regjistruar në ZRPP-në e Rrethit Korçë, me vol. nr. (***) , f. (***) , e ndodhur në zonën kadastrale (***) , me adresë: Rr. ‘(***) , p. (***) , shk. (***) , k. (***) , ap. (***) , Korçë, e kufizuar nga veriu me (***) , nga jugu me (***) , nga lindja me (***) dhe nga perëndimi me (***)”*.

- ✓ Trupit gjykues, nga analiza e dokumentacionit në tërësi, i ka rezultuar se kredia prej 26.000 CHF është disbursuar në datën 15.3.2007, dhe në po të njëjtën datë shuma prej 25.455 CHF ose 1.980.400 lekësh është transferuar në llogari të shoqërisë së ndërtimit “K.” sh.p.k., me përshkrimin “këst për blerje apartamenti”, dhe për pasojë, vlerëson se veprimi financiar përmes sistemit bankar legjitimon plotësisht njërin prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie, konkretisht, kredinë e marrë.

3.23.3 Në lidhje me vlerën 500.000 lekë depozitë

Përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. (***) prot., datë 17.9.2019, ka konfirmuar llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit. Në vijim, ka rezultuar se në llogarinë e pagës nr. (***) të bashkëshortit të subjektit, shtetasit N. R., në datën 13.2.2007 është kryer tërheqja e shumës 500.000 lekë.

- ✓ Trupi gjykues nuk konstatoi problematika në krijimin e kësaj shume.

3.23.4 Në lidhje me vlerën 500.000 lekë kursime, viti 2006

Trupi gjykues, nga verifikimi i deklaratës për vitin 2006, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar 700.000 lekë kursime. Më tej, duke ndjekur veprimin e radhës lidhur me provueshmërinë e legjitimitetit të kësaj shume me burim të ligjshëm, është kryer analiza financiare për vitin 2006, vit kur janë krijuar këto kursime, nga ku subjekti ka rezultuar me balancë pozitive, pra, thënë ndryshe, ka pasur mundësi financiare të krijojë me kursime, sikurse edhe ka deklaruar, pikërisht shumën 700.000 lekë. Si rrjedhim i kësaj analize dhe konstatimi, është evident dhe i pranueshëm fakti se prej kësaj shume, shuma 500.000 lekë ka ekzistuar dhe është përdorur si një ndër burimet e kësaj pasurie.

- ✓ Në të tilla kushte, trupi gjykues konstaton se subjekti ka kryer deklaram të mjaftueshëm në lidhje me njërin prej burimeve të kësaj pasurie, konkretisht, përdorimin e shumës 500.000 lekë, të krijuar nga kursimet.

3.23.5 Në lidhje me vlerën 800.000 lekë, të marrë me kontratë huaje

Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë hua në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, me përshkrimin “të ardhura nga kontrata e huas nr. (***) , datë 14.2.2008, huadhënës Sh. M.”. Vlera e huas: 800.000 lekë. Gjithashtu, këtë hua e deklaroi edhe si burim për blerjen e pasurisë apartament në qytetin e Korçës.

Subjekti është pyetur¹⁷ për burimin e krijimit të kësaj shume nga huadhënësi, që në të njëjtën kohë është edhe babai i saj. Në përgjigje të këtij pyetësi subjekti ka deklaruar: “Vlera 800.000 (tetëqind mijë lekë) është rezultat i aktivitetit bujqësor të prindërve të mi, Sh. dhe S. M., si të vetëpunësuar në bujqësi. Rezulton se familja me kryefamiljar babain tim është trajtuar me tokë bujqësore, e cila në fakt iu është vënë në përdorim anëtarëve të familjes bujqësore në një kohë më të hershme se sa data e aktit të marrjes së tokës në pronësi, nr. (***) , datë 9.8.1994, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, ‘Për tokën’, në muajin gusht 1991. Për këtë, subjekti ka depozituar vërtetimin nr. (***) prot, datë 22.10.2019 të Njesisë Administrative Maminas, Bashkia Shijak. Sipërfaqja e tokës me të cilën është trajtuar familja është 10.822 m². Duke shfrytëzuar këto sipërfaqe tokë bujqësore, si pasojë e aktivitetit të zhvilluar në bujqësi nga prindërit e mi, shitjes së produkteve bujqësore, janë krijuar në vijimësi të ardhura, mbi të cilat është mundësuar jetesa e familjes dhe kursimi i një pjesë të tyre.”

3.24 Subjekti ka depozituar disa dokumente¹⁸ për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua.

Nga dokumentacioni i depozituar, Komisioni konstatoi se sipas shkresës me nr. (***) prot., datë 18.3.2019, të Njesisë Administrative Maminas, paraqitet një përlllogaritje e përafërt e vlerës së produktit bujqësor që mund të merrej nga sipërfaqet e tokës që janë përdorur si serra (plastmasi) ndër vite. Në të përshkruhen pasuritë e përdorura si të tilla, ajo me nr. (***) , me sip. 1.470 m² dhe parcela tjetër, tokë arë, me nr. (***) , me sip. 5.670 m², me sipërfaqe totale 7.140 m². Rendimenti i prithshëm për një dynym perime (spinaq, specat, sallatë, domate, kastraveca, pjepër, patëllxhanë etj.), të kultivuar në serrë është rreth 55 kv. Në informacionin e kësaj njësie administrative, citohet se prodhimi total rezulton: 7.144 dy x 55kv/dy = 392.92 kv x 12.000 lekë/dy = 4.715.040 lekë të ardhura në vit.

¹⁷ Pyetësi nr. 2, datë 21.10.2019.

¹⁸ Vërtetim datë 21.03.2016, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës, mbi pagesën e kontributeve, si e vetëpunësuar në bujqësi për shtetasin S.M. (nëna e subjektit); vërtetim datë 21.10.2016, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës, mbi pagesën e kontributeve, si e vetëpunësuar në bujqësi, për shtetasin Sh. M. (babai i subjektit); vërtetim nr. (***) prot., datë 16.8.2016, i Njesisë Administrative Maminas, Bashkia Shijak; vërtetimi nr. (***) prot., datë 18.3.2019, i Njesisë Administrative Maminas, Bashkia Shijak; vërtetim nr. (***) prot., datë 25.3.2019, i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruaral; certifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm datë 28.3.2019, bashkëngjitur karta e fermerit; kontratë shitblerjeje, datë 30.8.1992, shoqëruar me vërtetim nënshkrimi nr. (***) , Kolegji i Avokatëve (blerë automjeti, bashkëngjitur akti noterial certifikata e pronësisë së shitësit); vërtetim nr. (***) , datë 18.3.2019, i Njesisë Administrative Maminas, Bashkia Shijak (për shlyerjen e taksave të tokës); vërtetim nr. (***) prot., datë 22.10.2019, i Njesisë Administrative Maminas, Bashkia Shijak (mbi mospasjen e detyrimeve të paslyera të taksave vendore); vërtetimi nr. (***) prot., datë 22.10.2019, i Njesisë Administrative Maminas, Bashkia Shijak; vërtetimi nr. (***) , datë 19.3.2019 i DRSSh-së Durrës; vërtetimi nr. (***) , datë 19.3.2019, i DRS.Sh. Durrës; shkresë nr. (***) prot., datë 10.1.2019, i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës; *statement* bankar¹⁸ në emër të shtetasit Sh. M. .

Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me “Raiffeisen Bank”¹⁹, i ka rezultuar se shtetasi Sh. M. ka pasur llogari depozite në RFZ. Nga analizimi i statement bankar, vihet re që shtetasi Sh. M. rezulton të ketë pasur depozita nga viti 2005 (kohë kur fillon informacioni i parë nga kjo bankë) në shumën 230.000 lekë, deri më 4.3.2009, kur kryen tërheqjen e fundit të shumës 1.595.200 lekë.

Sipas kontratës së huas, shuma prej 800.000 lekësh është dhënë në datën 14.2.2008 dhe subjekti ka depozituar mandatarkëtimin që në datën 18.2.2008, dhe i ka paguar shoqërisë ndërtimore “K.” sh.p.k., shumën 800.000 lekë.

Komisionit i ka rezultuar gjithashtu se në datën 3.3.2008 shtetasi Sh.M. ka kryer një derdhje në shumën 1.000.000 lekë.

Me gjithë nivelin e besueshëm të provueshmërisë që Komisioni kishte krijuar paraprakisht në lidhje me këtë burim krijimi të pasurisë, Komisioni vlerësoi t’i kërkojë subjektit të japë shpjegime²⁰ shtesë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

3.25 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e saj, ndër të tjera, ka shpjeguar se për sa i përket kërkesës shtesë *në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të huas në shumën 800 000 lekë*, marrë nga shtetasi Sh. M. (babai i subjektit), përdorur për blerjen e apartamentit/njesisë së banimit në qytetin e Korcës, në pyetësoin nr. 2 ka deklaruar se burimi i krijimit të tyre janë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti bujqësor/shfrytëzimi i tokës bujqësore, të fituar me ligj dhe nga shitja e produkteve të prodhuara.

3.26 Subjekti ka sqaruar mbi trajtimin e familjes (me kryefamiljar babain), me tokë bujqësore, e cila në fakt iu është vënë në përdorim anëtarëve të familjes bujqësore në një kohë më të hershme se data e aktit të marrjes së tokës në pronësi, nr. (***) , datë 9.8.1994, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, në gusht të vitit 1991 (gjendje fakti kjo në të gjithë vendin).

3.27 Subjekti ka sqaruar se prindërit e saj kanë paguar rregullisht kontributet e sigurimeve shoqërore nga vitit 1993 si të vetëpunësuar në bujqësi, dhe se pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore është shoqëruar me pagesën e taksës së tokës bujqësore, referuar vërtetimeve nr. (***) prot., datë 18.3.2019, dhe nr. (***) prot., datë 22.10.2019, të marra nga Njësia Administrative Maminas, Bashkia Shijak.

3.28 Po ashtu, subjekti i ka bazuar shpjegimet dhe provueshmërinë në disa referenca ligjore. Më konkretisht, ka cituar legjislacionin për sigurimet shoqërore në fuqi dhe aktualisht, ku të vetëpunësuarit në bujqësi duhet të plotësojnë disa kushte: a) të mos jenë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë; b) të kenë tokë bujqësore në pronësi, ose në përdorim; c) të ushtrojnë aktivitetin bujqësor dhe blegtoral; ç) të jenë banorë në rrethin që kanë tokë dhe ushtrojnë aktivitetet.

¹⁹ Shkresë nr. (***) prot., datë 17.9.2019, në dosjen e Komisionit.

²⁰ Referuar nenit 52, të ligjit nr. 84/2016.

3.29 Subjekti ka sqaruar se prindërit e saj, për shkak se kanë plotësuar kushtet, përfshirë edhe ushtrimin e aktivitetit bujqësor, janë konsideruar të vetëpunësuar, duke hyrë në sferën e mbulimit të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

3.30 Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, rezulton se të ardhurat e realizuara nga të vetëpunësuarit në bujqësi apo shitësit ambulantë, *nuk konsiderohen si të ardhura të tatueshme*. Ndërsa, në pikën 11, të nenit 8/1, të po këtij ligji është parashikuar se, *përfshihen nga tatimi mbi të ardhurat, të ardhurat e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore, apo një person fizik ose juridik që kryen aktivitet bujqësor*.

3.31 Të vetëpunësuarit në bujqësi nuk kanë pasur detyrimin të regjistroheshin si tregtarë dhe as të pajiseshin me leje të posaçme për shitjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale, që buronin nga shfrytëzimi i tokës bujqësore, të përfituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”.

3.32 Fryma e legjislacionit dhe politikat ekonomike shtetërore, ku rezulton përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat e realizuara nga të vetëpunësuarit në bujqësi, ka qenë mbështetja e të vetëpunësuarve në bujqësi, dhe kjo për të mundësuar shtimin e prodhimit vendas që buronte nga shfrytëzimi dhe moslënia djerrë e tokave bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”. Jo vetëm në atë periudhë, por edhe sot, politikat qeverisëse nxisin dhe mbështesin zhvillimin e prodhimeve bujqësore nëpërmjet lehtësimit të barrës fiskale dhe miratimit të politikave dhe strategjive të zhvillimit bujqësor dhe rural.

3.33 Subjekti ka reflektuar si të ardhura minimale të realizuar për vitet 1993 – 2007, shumën totale prej 2.686.560 lekësh, duke presupozuar se i vetëpunësuarit (prindërit e saj) ka realizuar, për të cilat janë paguar edhe kontributet e sigurimeve shoqërore, duke sqaruar, që në raport me këto të ardhura, vlera prej 800.000 lekësh, që prindërit i kanë dhënë hua në datën 14.2.2008, është vetëm 29.7 %.

3.34 Subjekti ka sqaruar gjithashtu se i është referuar edhe një raporti të INSTAT-it për vitin 2002, ku është përcaktuar një kosto reale për frymë në shumën 4.891 lekë (3.047 lekë për frymë ushqime dhe 1.844 lekë për artikujt bazë joushqimorë) bazuar në pagën minimale. Mbi këtë, subjekti ka paraqitur një llogaritje të përafërt të minimumit jetik sipas viteve, për të arritur në një konkluzion lidhur me kursimet e mundshme të prindërve, sipas të cilës ka rezultuar se niveli i kursimeve ka qenë në shumën 1.288.691 lekë, që duke marrë për bazë pagën minimale sipas viteve dhe një përlllogaritje bazë të minimumit jetik sipas viteve, kjo vlerë, sipas subjektit, është në atë masë e cila justifikon burimin e huas në shumën 800.000 lekë.

3.35 Subjekti është shprehur se në konkluzion të analizës, duke marrë për bazë të ardhurat nga burime të ligjshme (pagën minimale, sipas viteve pasi provohet e konfirmuar nga institucionet përkatëse pagesa e kontributeve), rezulton se huaja e marrë në shumën 800.000 lekë është 29.7 % e të ardhurave ($800.000 \cdot 100 / 2.686.560$) dhe më e vogël se kursimi (në vlerën 1.288.691 lekë).

3.36 Po ashtu, subjekti ka argumentuar edhe mbi të ardhurat *neto* të siguruara nga shitja e produkteve bujqësore, ku referuar relacionit nr. (***)prot., datë 27.1.2020, konfirmohet një e ardhur *neto* e realizueshme prej prodhimit bujqësor në shtatë dynym serrë, 1.7444.565 lekë.

3.37 Subjekti ka depozituar:

- kërkesë nr. (***) prot, datë 23.10.2019;
- shkresë nr. (***)prot., datë 29.10.2019, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë;
- kërkesë datë 30.10.2020, drejtuar Institutit të Statistikave;
- shkresë nr. (***) prot., datë 14.11.2019, të Drejtorisë së Përgjithshme të Prodhimit Statistikor (Drejtoria e Statistikave Sociale);
- relacion nr. (***)prot., datë 27.1.2020, të Njesisë Administrative Maminas, Bashkia Shijak;
- certifikatë familjare datë 24.1.2020;
- faturë pagese rroge e muajit korrik të vitit 2010; dhe
- vërtetimi i pagës vjetore të vitit 2009, për shtetasin S. M. .

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.38 Trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike për marrjen e kësaj huaje, me qëllim blerjen e pasurisë, të deklarimeve në pyetësorë përgjatë hetimit administrativ, si dhe të provave të administruara, arsyeton lidhur me aftësinë paguese të huadhënësit, babait të subjektit, për shumën 800.000 lekë, si vijon:

3.38.1 Fillimisht është konstatuar se marrëdhënia e huas e lidhur midis bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe huadhënësit, babait të subjektit, është finalizuar nëpërmjet një kontrate noteriale huaje me nr. (***), datë 14.2.2008, të nënshkruar mes palëve, në përputhje me parashikimin e nenit 1050 të Kodit Civil.

3.38.2 Po ashtu, në kontratë është parashikuar edhe mënyra e shlyerjes së kësaj huaje.

3.38.3 Njëkohësisht, është konstatuar se huaja është deklaruar në deklaratën për vitin 2008 si një ndër burimet e krijimit të pasurisë.

3.38.4 Në kushtet kur konfirmohet një marrëdhënie huaje, sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, dhe pikës 14, të nenit 3, të po këtij ligji, nga ku rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit përfshihet në rrethin e personave të tjerë të lidhur, atëherë Komisioni ka analizuar ligjshmërinë e burimit të shumës 800.000 lekë, dhënë hua.

3.39 Në vijim, trupi gjykues, nisur nga faktet që:

- familja e origjinës së subjektit të rivlerësimit, me kryefamiljar babain e saj, është trajtuar me tokë me sipërfaqe relativisht të konsiderueshme, sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”;
- prindërit e subjektit kanë paguar rregullisht kontributet e sigurimeve shoqërore nga viti 1993, si të vetëpunësuar në bujqësi;
- pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore është shoqëruar me pagesën e taksës së tokës bujqësore, referuar vërtetimeve nr. (***) prot., datë 18.3.2019 dhe nr. (***) prot., datë 22.10.2019, të marra nga Njësia Administrative Maminas, Bashkia Shijak;

- duke mbajtur në vëmendje se pagesa e kontributeve shoqërore vërtet është shpenzim i kryer nga kontribuuesi, por në linjë të drejtpërdrejtë reflekton të ardhurat minimale të realizuara, të cilat padyshim të krijojnë bindjen se janë realizuar, për sa kohë është konfirmuar institucionalisht se janë përfituar nga një pasuri e cila ka një sipërfaqe të dallueshme prodhimtare, se në këtë sipërfaqe investohet dhe punohet në kushte serre dhe, për pasojë, produktiviteti mbetet evident dhe justifikon burimin e krijimit të të ardhurave;
- referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, më konkretisht, në pikën 11, të nenit 8/1, të këtij ligji është parashikuar se përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, të ardhurat e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore, apo një person fizik ose juridik që kryen aktivitet bujqësor;
- Njësia Administrative Maminas, Bashkia Shijak, me vërtetimin nr. (***) prot., datë 18.3.2019, ka sqaruar lidhur me veprimtarinë e punës së kësaj familjeje bujqësore, që me përfitimin e tokës dhe në vijim ka pasqyruar lidhur me rendimentin e arritur, duke dhënë edhe detaje mbi të ardhurat e realizuara;
- përpara vitit 2008 nuk ka funksionuar skema e TVSH-së për fermerin, por ajo u përfshi në legjislacion vetëm pas vitit 2012, nëpërmjet së cilës fermerët që kërkonin rimbursim të TVSH-së duhet të deklaronin shitjet tyre;
- prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë mbajtur marrëdhënie edhe me sistemin bankar;
- bëhet i pranueshëm edhe sqarimi i subjektit në prapësime se shpenzimet minimale të një të vetëpunësuarit në bujqësi *janë më të vogla se ajo e një personi tjetër që realizon jetesën e përditshme, jo nga shfrytëzimi i tokës bujqësore dhe marrja prej saj e produkteve të jetesës së përditshme (kostoja e ushqimit), apo që jeton në zona ku dihet që kostoja e jetesës është dukshëm më lartë se në zona të tjera;*
- në aktin e emërtuar “relacion” me nr. (***) prot., datë 27.1.2020, të Njesisë Administrative Maminas, të depozituar nga subjekti në prapësime, rezulton të jetë bërë një përlllogaritje e detajuar e rendimentit/prodhimit të shtatë dynym tokë bujqësore në Maminas, ku është qartësuar se të vetëpunësuarit i kanë kryer vetë shumicën e shërbimeve; është konfirmuar vlera e të ardhurave bruto nga shitja e produkteve bujqësore të prodhuara në shtatë dynym serrë, me vlerë 4.715.040 lekë; janë zbritur kostot e tjera nga kjo vlerë, që në total shkojnë 63 %, dhe që për pasojë, sipas këtij relacioni shpjegues, lehtësisht identifikohet mundësia e mbetjes nga vlera 100 %, nga e cila provohet edhe burimi i shumës së dhënë hua,

si dhe duke vlerësuar faktin që i vetëpunësuarit është familjarizuar me rregullat, pra, ka paguar kontribute, ka ushtruar aktivitetin në kushte ambientale të mira, ka arritur produktivitet të mirë e të matshëm, por edhe duke vlerësuar shpjegimet bindëse të subjektit të rivlerësimit përmes depozitimit të provave, për të provuar aftësinë e krijimit të shumës së marrë hua nga babai, trupi gjykues krijon bindjen se huadhënësi ka pasur mundësi financiare për të dhënë hua shumë 800.000 lekë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, shumë e deklaruar se është përdorur si një ndër burimet e krijimit të kësaj pasurie.

- Në lidhje me huan e marrë nga shtetasi H. H., me qëllim shlyerjen para kohe të kredisë së përfituar në shumën 26.000 CHF, në BKT, si burim i kësaj pasurie

3.40 Komisionit, gjatë hetimit administrativ, i ka rezultuar se subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 të ardhura nga kontrata e huas nr. (***) , datë 14.9.2011, lidhur me shtetasin H. H., në shumën 500.000 lekë.

3.40.1 Po ashtu, sikurse është kërkuar nga ligji nr. 84/2016, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se kjo hua është marrë për të mbyllur kredinë e marrë në BKT përpara afatit.

3.40.2 Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2011 subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e kësaj huaje.

3.40.3 Në vijim, po gjatë hetimit, ka rezultuar se kjo hua konfirmohet me kontratën përkatëse të huas²¹ dhe deklaratën noteriale nr. (***) , datë 24.9.2012, sipas të cilës është shlyer huaja.

3.40.4 Nga korrespondenca e mbajtur me BKT-në²² vihet re se në datën 14.9.2011 bashkëshorti i subjektit, N. R., ka derdhur në llogari shumën 435.000 lekë, shumë kjo e cila në të njëjtën datë është konvertuar në monedhën CHF për të mbyllur kredinë.

3.40.5 Subjekti është pyetur²³ në lidhje me burimin e krijimit të kësaj vlere nga huadhënësi dhe në përgjigje të tij ka deklaruar: “*Burimi i krijimit të kësaj vlere nga huadhënësi janë të ardhurat të siguruara nga paga ndër vite*”.

3.41 Në lidhje me këtë subjekti ka depozituar vërtetimet e punësimit si vijon:

- i. Për periudhën 20.3.2006 – 6.9.2007 ka ushtruar detyrën e Avokatit të Shtetit pranë Zyrës Vendore Korçë, me të ardhura *neto* gjatë kësaj periudhe 1.245.332 lekë.
- ii. Për periudhën 10.9.2007 – 10.6.2008 ka ushtruar detyrën pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me pagë *bruto* 66.060 lekë dhe me pagë *neto* 52.096 lekë, të ardhura *bruto* për këtë periudhë gjithsej 660.703 lekë, të ardhura *neto* 528.198 lekë, sipas vërtetimit nr. (***) prot., datë 22.10.209.
- iii. Për periudhën maj 2009 – gusht 2015 ka qenë i punësuar pranë ish-Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ka përfituar të ardhura *bruto* 5.400.139 lekë, ndërsa për periudhën maj 2009 – gusht 2011 ka përfituar të ardhura *bruto* në shumën 1.849.452 lekë, sipas vërtetimit nr(***)prot., datë 22.10.2019.

3.42 Komisioni, nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit ka konstatuar se huadhënësi ka punuar kryesisht në institucione shtetërore. Të ardhurat e përfituara nga këto punësime në raport me shpenzimet e jetesës për periudhën e dhënies së huas kanë rezultuar të mjaftueshme për të justifikuar këtë huadhënie.

3.43 Gjithashtu, lidhur me mundësinë e krijimit të kësaj shume nga huadhënësi, Komisioni mbajti korrespondencë²⁴ edhe me bankat e nivelit të dytë, nga ku ka rezultuar se në tërësi

²¹ Aneks 4/3, në dosjen e ILDKPKI-së.

²² Nr. (***) prot., datë 1.10.2019, në dosjen e Komisionit.

²³ Pyetësori nr. 2, datë 21.10.2019, në dosjen e Komisionit.

²⁴ Shkresë nr. (***) prot., datë 21.11.2019, e Komisionit.

huadhënësi ka llogari në disa prej këtyre bankave, në monedha të ndryshme, ku vihen re lëvizje dhe transaksione prej vitit 2004 dhe në vazhdim.

Analiza e provave dhe fakteve

3.44 Në tërësi, trupi gjykues, në analizë të kësaj huamarrjeje, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2011 marrjen e huas, bazuar në kontratën e huas nr. (***) , datë 14.9.2011, lidhur me shtetasin H. H., në shumën 500.000 lekë.

3.45 Gjithashtu, subjekti ka deklaruar saktësisht në deklaratën “Vetting” qëllimin e përdorimit të kësaj huaje për të shlyer përpara kohe kredinë e marrë dhe përdorur në funksion të kësaj pasurie.

3.46 Njëkohësisht, subjekti ka deklaruar edhe shlyerjen e huas një vit më pas, sikurse ishte parashikuar në kontratë, fakt të cilin e ka pasqyruar me deklaratën noteriale në kohë reale, pikërisht të dhënë në vitin 2012.

3.47 Trupi gjykues ka konstatuar se të gjitha veprimet e kryera me këtë hua, në dobi të shlyerjes së kredisë, janë realizuar me akte noteriale në kohë reale.

3.48 Në lidhje me vërtetësinë e qëllimit të përdorimit të kësaj huaje është konstatuar se ka kaluar për llogari të shlyerjes së kredisë në të njëjtën datë që është marrë nga shtetasi H. H., konkretisht në datën 14.9.2011.

3.49 Në lidhje me dokumentacionin e administruar mbi punësimin e huadhënësit, për të provuar burimin e ligjshëm të huas së dhënë, trupi gjykues ka konkluduar se në tërësi huadhënësi ka qenë i punësuar në administratë shtetërore, legjitimiteti i të ardhurave të të cilave është në nivel tërësisht të provuar dhe që rezulton në vlerën *bruto* 4.052.761 lekë, për periudhën mars 2006 – gusht 2011, vlerë e cila, në raport me shumën e dhënë hua dhe me shpenzimet e huadhënësit, pas kryerjes së analizës financiare, ka rezultuar pozitive. Në këto kushte konkludohet se huadhënësi ka pasur mundësi financiare për të dhënë hua shumën 500.000 lekë dhe se arrin të justifikojë aftësitë financiare të tij me burime të ligjshme.

Nga ana tjetër, është konstatuar se huadhënësi ka kryer transaksione bankare në llogaritë bankare, veprime të cilat krijojnë bindjen e plotë dhe të besueshme se huadhënësi ka qenë në kushte optimale për të dhënë hua në një shumë të arrirë në krahasim me punësimet e kryera.

3.50 Po ashtu, njësia e shërbimit ligjor kreu analizën financiare për vitet 2011 - 2012, kohë kur është marrë huaja për të mbyllur kredinë dhe kur është shlyer, dhe në përfundim konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të shlyejë kredinë në vitin 2011 dhe huan në vitin 2012.

3.51 Për të gjitha argumentet e bëra prezent më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzion se:

- ✓ Subjekti ka bërë deklaram të mjaftueshëm në lidhje me marrjen e huas, në shumën 800.000 lekë, shtetasit H. H., se huadhënësi ka pasur mundësi financiare për të dhënë huan dhe reciprokisht edhe subjekti i rivlerësimit ka rezultuar në balancë pozitive për ta shlyer.

- Komisioni ka hetuar edhe në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj me shtetasin H. H. me cilësinë e huadhënësit.

3.52 Nga korrespondenca²⁵ e mbajtur me institucionet punëdhënëse të subjektit dhe bashkëshortit të saj nuk është konfirmuar shqyrtimi i ndonjë procesi gjyqësor në favor të këtij shtetasi. Po ashtu, Komisioni ka pyetur²⁶ edhe subjektin e i cili ka cituar shprehimisht se: “ ... *marrëdhënia e tij me huadhënësin ka qenë shoqërore/miqësore, marrëdhënie që e ruajmë dhe sot...as unë, as bashkëshorti im nuk kemi gjykuar çështje me palë ndërgjyqëse shtetasin H. H..* ”

- Në lidhje me çmimin e paguar për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 3.800.000 lekë.

3.53 Komisioni për të konkluduar në lidhje me trajtimin preferencial (ose jo) të pagesës së bërë për blerjen e kësaj pasurie, i ka kërkuar shoqërisë ndërtimore “K.” sh.p.k., të japë informacion, si dhe të depozitojë dokumentacion shoqërues mbi pagesat e kryera për këtë pasuri, por edhe të depozitojë kontrata të ngjashme të blerësve të tjerë në të njëjtën godinë dhe në të njëjtën kohë.

3.54 Shoqëria²⁷ “K.” sh.p.k., ka informuar se pagesat për këtë pasuri janë kryer në datën 15.2.2007, në shumën 500.000 lekë, me mandatarkëtimin nr. (***) , në datë 19.2.2007, në shumën 500.000 lekë, me mandatarkëtimin nr., (***) në datë 15.3.2007, në shumën 1.980 399 lekë (kredi), kaluar nëpërmjet BKT-së dhe në datën 18.2.2008, në shumën 800.000 lekë (cash) me mandatarkëtimin nr. (***) dhe se pas shlyerjes së të gjithë kësteve të pasurisë është formalizuar edhe kontrata e shitblerjes. Kjo shoqëri ka vënë në dispozicion mandatet përkatëse të cilat përkojnë me deklaratimet e subjektit dhe janë të njëjta me aktet e vëna në dispozicion prej saj.

3.55 Gjithashtu, shoqëria²⁸ ndërtimore ka depozituar tri aktmarrëveshje për shitje banese në të njëjtën godinë, përkatësisht me shtetasit G. B. dhe J. B. në datën 29.5.2007, për një sipërfaqe banimi 70 m², në shumën 2.800.000 lekë, me shtetasin Dh. F. më 5.7.2007, për një sipërfaqe banimi 100 m² (të dhëna të cilat përkojnë edhe me të dhënat e pasqyruara në aktmarrëveshjen e nënshkruar me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, për këtë pasuri), në shumën 3.700.000 lekë, si dhe me shtetasin B. R. në datën 17.2.2007, përsëri për një sipërfaqe 100 m², në shumën 3.800.000 lekë.

3.56 Në analizë të përgjigjes së dhënë nga shoqëria ndërtimore dhe dokumentacionit të depozituar, konkretisht mandatarkëtimet e cituara më sipër, të cilët pasqyrojnë pagesat e bëra për këtë pasuri dhe që rakordojnë plotësisht me deklaratimet dhe mandatet e depozituara nga subjekti, si dhe në analizë të aktmarrëveshjeve të depozituara të cilat i përkasin blerësve të ndryshëm, rezulton se aktet pasqyrojnë të njëjtat shuma thuajse për të njëjtat sipërfaqe banimi

²⁵ Shkresë nr. (***)prot, datë 14.11.2019 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shkresës nr. (***)prot, datë 19.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Korçë, shkresës nr. (***) prot, datë 21.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Pogradec, shkresës nr. (***)prot, datë 19.11.2019 e Gjykatës së Shkallës së Parë për krime të Rënda, Tiranë.

²⁶ Referojuni pyetësorit datë 13 nëntor 2019, në dosjen e Komisionit.

²⁷ Referojuni shkresës nr. (***)prot, datë 27.11.2019 si dhe dokumentacionit bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit.

²⁸ Referojuni dokumentacionit bashkëngjitur shkresës nr. (***) prot, datë 27.11.2019, në dosjen e Komisionit.

dhe për të njëjtët vite porositje apartamentesh. Në këto kushte trupi gjykues arrin në konkluzion se:

- ✓ Subjekti nuk është trajtuar me çmim preferencial në blerjen e kësaj pasurie.

3.57 Në lidhje me mundësinë e subjektit për të investuar blerjen e kësaj pasurie, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare për vitet 2006 – 2008²⁹, nga ku ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë në këtë pasuri, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare përgjatë këtyre viteve.

3.58 Në këto kushte, trupi gjykues arrin në konkluzion se:

- ✓ Subjekti ka bërë deklaram të mjaftueshëm në lidhje me ekzistencën e kësaj pasurie, si dhe burimin e krijimit të saj, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.84/2016.

4. Në lidhje me pasurinë, apartamenti i banimit, me sip. të brendshme 86 m², me sip. të përbashkët 9.03 m², me sip. të përgjithshme 95.03 m² (pasuria nr. (***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. nr. (***)) me strukturë 2+1, ndodhur në Rr. “(***)”, Tiranë, në gjendje të mobiluar dhe garazh me sip. 17.7 m², vendparkim nr. (***) (pasuria nr. (***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. nr. (***) , me sip.), në bashkëpronësi me bashkëshorten Miliana Muça (si blerës), referuar kontratës së shitblerjes nr. (***) , datë 4.9.2015, me kushte dhe rezervë për pasurinë e paluajtshme. Vlera: 10.000.000 lekë. Pjesa takuese: 1/2 pjesë e pandarë në bashkëpronësi bashkëshortore.

4.1 Ky apartament dhe garazhi janë blerë nga shitësit K. dhe V. Y. (bashkëshortë mes tyre) për çmimin: vlera e apartamentit 9.000.000 lekë dhe vlera e garazhit 1.000.000 lekë, çmim në të cilin është përfshirë edhe gjendja e mobilimit të banesës në momentin e blerjes dhe të dorëzimit fizik.

4.2 Likuidimi i këtij çmimi është bërë, si më poshtë:

4.2.1 Shuma 5.000.000 lekë ka kaluar në llogari të shitësve K. dhe V. Y. nga kredia që blerësit N. R. dhe Miliana Muça kanë marrë në “Raiffeisen Bank”, në bazë të kontratës së kredisë bankare dhe hipotekës me nr. (***) , datë 17.9.2015.

4.2.2 Sipas shënimit në seksionin E të kartelës së kësaj pasurie të paluajtshme, bërë në datën 18.9.2015, kjo pasuri është bllokuar në favor të “Raiffeisen Bank”, për shlyerjen e shumë prej 5.000.000 lekësh kredi, referuar kontratës së mësipërme, datë 17.9.2015.

4.2.3 Shuma 4.000.000 lekë është marrë hua nga shoqëria “B.” sh.p.k., me qendër në Pogradec dhe me adresë: lagjja nr. (***) , “Rruga (***)”, regjistruar në QKR, me NIPT (***) , me administrator z. L. B., referuar kontratës së huas nr. (***) , datë 3.9.2015, dhe vërtetimit datë 3.9.2015, të “Raiffeisen Bank” për kalimin e shumë nga llogaria e shoqërisë, ndërsa në pjesën mbi detajet është bërë shënimi “dhënie huaje për blerje apartamenti”.

4.2.4 Pjesa tjetër prej 1.000.000 lekësh është tërhequr nga llogaria e subjektit Miliana Muça (blerëse së bashku me bashkëshortin N. R.), duke u pakësuar dhe mbyllur llogaria e kursimit në emër të saj në “Union Bank”, në vlerën që ekzistonte në shtator të vitit 2015, shumë e cila buron nga paga si gjyqtare, lënë pjesërisht në llogarinë e pagës dhe e kaluar në vijim në llogari kursimi në datën 7.5.2014 (sipas dokumentit “nxjerrje llogarie” e “Union Bank” e

²⁹ Është analizuar nga viti 2006, periudhë në të cilën janë krijuar kursimet e para cash, viti 2007 kur është marrë kredia dhe viti 2008 kur është marrë hua.

printuar në datën 20.10.2016, 4 fletë). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁰.

4.3 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e institucioneve.

Hetimi i kryer nga Komisioni

4.4 Kjo pasuri është deklaruar:

4.4.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 me përshkrimin “blerje apartament banimi” (pasuria me nr. (***)+(***), me sip. 86 m², me strukturë 2+1, Rr. “(***),” Tiranë, i mobiluar) dhe garazh (pasuria me nr. (***) – (***), me sip. 17.7 m², vendparkimi nr. (***)). Vlera: 10.000.000 lekë. Pjesa takuese 50 %. Nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie.

4.4.2 Kjo pasuri konfirmohet me kontratën e shitblerjes³¹ nr. (***) datë 4.9.2015, me kusht dhe rezervë (pasuri e paluajtshme), me palë shitëse shtetasin K. Y. dhe palë blerëse shtetasin N. R. dhe Miliana Muça. Çmimi në kontratën e shitblerjes është 10.000.000 lekë, ku në këtë vlerë është përfshirë edhe vlera e mobilimit të apartamentit: vlera e apartamentit në shumën 9.000.000 lekë; dhe vlera e garazhit në shumën 1.000.000 lekë.

4.4.3 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, me shkresën nr. (***)prot., datë 14.10.2019, konfirmon të regjistruar në emër të shtetasve Miliana Sh. Muça dhe N. Dh. R., pasuritë:

- apartament me sip. 86 m², z.k. (***), vol. (***), f. (***);
- garazh me sip.17.7 m², z.k. (***), vol. (***), f. (***)

4.4.4 UKT-ja me shkresën nr. (***)prot., datë 24.9.2019, identifikon një abonent me kontratë me nr. (***) për objektin me adresë: Rr. “(***),” Tiranë. Kontrata është me status aktiv në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të likuiduara deri në muajin korrik 2019.

4.4.5 OSHEE-ja me shkresën nr(***)prot., datë 3.10.2019, konfirmon në emër të z. N. Dh. R. (bashkëshorti i subjektit), një kontratë furnizimi nr. (***) në instancën Tiranë. Komisioni, nga analiza e dokumentacionit të këtij institucioni, konstaton se kjo kontratë është hapur në datën 23.9.2013 dhe se ndryshimi i emrit është kryer në datën 11.2.2016.

4.5 Sipas kontratës pagesa për blerjen e apartamentit do të kryhet, si vijon:

- vlera prej 5.000.000 lekësh likuidohet nga blerësi nëpërmjet llogarisë së noterit ngurtësim në “Raiffeisen Bank”;
- vlera prej 5.000.000 lekësh do të likuidohet nga blerësi nëpërmjet kredisë në “Raiffeisen Bank”.

³⁰ Certifikatë pronësie nr. (***) datë 9.9.2015; certifikatë pronësie nr. (***) datë 9.9.2015; kontratë shitblerjeje me kusht dhe rezervë nr. (***) datë 4.9.2015; kopje kartelet e pasurisë (***) ku sipas shënimit në seksionin E të kartelës datë 18.9.2015, kjo pasuri është bllokuar në favor të “Raiffeisen Bank”, për shlyerjen e shumës 5.000.000 lekë; nxjerrje llogarie në emër të znj. Miliana Muça, e printuar në datën 20.10.2016 nga “Union Bank”; mandat tërheqjeje të shumës 148.000 lekë nga llogaria e shtetasës Miliana Muça, në “Union Bank”, datë 4.9.2015 (dy copë). Urdhërpagesë e brendshme, datë 4.9.2015, kryer nga znj. Miliana Muça në “Union Bank”; mandat tërheqjeje të shumës 50.000 lekë nga llogaria e shtetasës Miliana Muça në “Union Bank”, datë 26.8.2015; urdhërpagesë e brendshme, datë 7.9.2015, kryer nga znj. Miliana Muça në “Union Bank”; kontratë huaje nr. (***) datë 3.9.2015; njoftim debitimi, datë 3.9.2015, i “Raiffeisen Bank”. Njoftim debitimi datë 4.9.2015, i “Raiffeisen Bank”; vërtetim datë 18.10.2016, nga shoqëria “B.” sh.p.k.; vërtetim datë 20.1.2017, nga shoqëria “B.” sh.p.k.; vërtetim datë 20.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”; kontratë kredie bankare dhe hipoteke me nr. (***) datë 17.9.2015 (Aneks nr. 4/4, në dosjen e ILDKPKI-së).

³¹ Aneks 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

4.6 Subjekti ka deklaruar burim krijimi për këtë pasuri:

- Kontratë kredie bankare dhe hipoteke nr. (***), datë 17.9.2015, në shumën 5.000.000 lekë në “Raiffeisen Bank”. Qëllimi i kredisë është për blerje shtëpie.
- Kontratë huaje nr(***), datë 3.9.2015, në shumën 4.000.000 lekë nga shoqëria “B.” sh.p.k.
 - Shuma 1.000.000 lekë nga kursimet në llogarinë në “Union Bank”.

4.7 Komisioni hetoi mbi çdo burim krijimi të kësaj pasurie për të parë ligjshmërinë e tyre, si dhe mundësinë financiare të subjektit.

4.8 Në lidhje me kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank”

4.8.1 Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me të gjitha bankat e nivelit të dytë, i rezultoi se “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. (***) prot., datë 17.9.2019, ka konfirmuar kredinë e marrë në emër të bashkëshortit të subjektit, shtetasit N. R. . Më tej, nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se për këtë kredi është lidhur kontratë kredie bankare dhe hipoteke nr. (***), datë 17.9.2015, në shumën 5.000.000 lekë. Në kontratë është përcaktuar qëllimi i kredisë për blerje apartamenti dhe, njëkohësisht, është vërejtur se ky apartament është vendosur për sigurimin e kredisë. Kredia është disbursuar në datën 21.9.2015 dhe në po të njëjtën datë është kaluar me urdhërshirimi bankar në llogarinë e noteres, Xh. B., PF me përshkrimin “kalim për blerje shtëpie me nr. (***), datë 3.9.2015, pagesë përfundimtare”.

- ✓ Trupi gjykues, nga analiza e dokumentacionit dhe deklarimi i subjektit lidhur me përfitimin dhe përdorimin e kësaj kredie, konkludon se provohet vërtetësia dhe saktësia e njërës prej burimeve të përdorura për përfitimin e kësaj pasurie.

4.9 Në lidhje me huan në shumën 4.000.000 lekë

4.9.1 Komisioni, nga hetimi, ka konstatuar se këtë hua subjekti e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, me përshkrimin “huamarrje nga shoqëria ‘B.’ sh.p.k.” (referuar kontratës së huas nr. (***), datë 3.9.2015), në shumën 4.000.000 lekë. Pjesa takuese: bashkëshorti 100 %.

4.9.2 Subjekti ka depozituar³² kontratën e huas dhe bilancin e vitit 2015, të shoqërisë “B.” sh.p.k., ku pasqyrohet huaja e dhënë, si dhe mënyra e shlyerjes së saj pas shitjes së pasurisë nr. (***), të hetuar dhe trajtuar më sipër.

4.9.3 Gjatë hetimit ka rezultuar se huaja e dhënë nga shoqëria “B.” sh.p.k., është kaluar me transaksion bankar në datën 3.9.2015, në “Raiffeisen Bank” nga shoqëria “B.” sh.p.k., të bashkëshorti i subjektit, z. N. R., me përshkrimin “dhënie huaje për blerje apartamenti”.

4.9.4 Në datën 4.9.2015 kjo shumë është kaluar me urdhërshirim në llogarinë e noteres Xh. B., PF me përshkrimin “kalim në bazë të kontratë huas nr. (***), datë 3.9.2015”.

4.9.5 Komisioni ka konstatuar njëkohësisht në lidhje me këtë hua se subjekti në deklaratën “Vetting” në rubrikën përkatëse të detyrimeve financiare ka deklaruar edhe në lidhje me detyrimin e përbashkët me bashkëshortin N. R. për shlyerjen e kësaj huaje.

4.10 Gjatë hetimit subjekti është pyetur dhe në përgjigjen e dhënë ka konfirmuar edhe shitjen e pasurisë nr. (***), të pasqyruar dhe të trajtuar më sipër në këtë vendim, duke përmbyllur kështu kushtin e vendosur në kontratën e huas se shlyerja do të realizohej pas shitjes së

³² Aneks 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

pasurisë me vendndodhje në Korçë. Për këtë veprim të kryer subjekti ka depozituar edhe dokumentacionin provues.

Analiza e provave dhe fakteve

4.11 Trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit lidhur me përfitimin dhe shlyerjen e kësaj huaje, si dhe të dokumentacionit të administruar në lidhje me këtë çështje, arsyeton si vijon:

4.11.1 Fakti që kjo shumë është marrë hua me qëllim për blerjen e apartamentit me sip. të brendshme 86 m², me sip. të përbashkët 9.03 m², me sip. të përgjithshme 95.03 m², konkretisht të pasurisë nr. (***) , z.k. (***) , vol. (***) , f. (***) , me strukturë 2+1, të ndodhur në Rr. “(***)”, Tiranë, provohet plotësisht nga disa prova shkresore.

4.11.2 Kontrata e huas, e cila rezulton të jetë hartuar e nënshkruar në përputhje me parashikimet ligjore të Kodit Civil, ka qartësuar se huaja i merret shoqërisë “B.” sh.p.k., me administrator shtetasin L. B., me përshkrimin “dhënie huaje për blerje apartamenti”. Po ashtu, në kontratë është përcaktuar shuma e dhënë hua, kalimi i saj me transfertë nëpërmjet bankës nga llogaria e shoqërisë, si dhe është përcaktuar se huaja do të shlyhet në momentin e shitjes së apartamentit, që bashkëshorti i subjektit ka në Korçë.

4.11.3 Shuma e marrë hua ka kaluar në datën 4.9.2015, me urdhërxhirim në llogarinë e noteres Xh. B., PF me përshkrimin “kalim në bazë të kontratë huas nr. (***) , datë 3.9.2015”.

4.11.4 Është konstatuar se huaja është pasqyruar edhe në bilancin e shoqërisë “B.” sh.p.k., për vitin 2015.

4.11.5 Trupi gjykues konstaton se në tërësi subjekti ka treguar kujdesin e shtuar, duke kryer kryesisht veprime financiare nëpërmjet sistemit bankar, me përshkrimet përkatëse me qëllim provueshmërinë e ligjshmërisë së burimit të krijimit të huas, si dhe ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë.

4.11.6 Trupi gjykues, pasi është njohur edhe me deklarinimin³³ e subjektit gjatë hetimit administrativ, se pasuria në qytetin e Korçës është shitur, se shuma e huas së marrë nga shoqëria “B.” sh.p.k., është shlyer tërësisht në datën 18.2.2019, dhe burimi i krijimit të kësaj vlere është vlere në lekë e çmimit të shitjes së njësisë së banimit të ndodhur në Korçë, ka analizuar edhe provat³⁴ e depozituara për këtë deklarinim, nga ku ka konstatuar se pasuria është shitur me kontratë shitblerjeje nr. (***) , datë 9.2.2019, në shumën 4.650.000 lekë, shumë e depozituar nga blerësi në datën 15.2.2019, në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank” dhe më tej, po nga kjo llogari me transfertë bankare në datën 18.2.2019, ka kaluar në favor të shoqërisë ndërtimore “B.” sh.p.k., shumën 4.000.000 lekë, me përshkrimin “kthim huaje”.

4.12 Nën këtë arsyetim të bazuar në prova e fakte bindëse, trupi gjykues arriti në konkluzionin se:

³³Referuar pyetjes së drejtuar me e-mail, datë 19.11.2019, dhe përgjigjes së dhënë në datën 20.11.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁴ Ekstrakt të regjistrimit tregtar për shoqërinë “B.” sh.p.k., me NIPT (***) ; kontratë huaje nr. (***) , datë 3.9.2015, bashkëngjitur certifikata e regjistrimit e subjektit datë 6.10.2008, karta e identitetit, dokumenti bankar datë 3.9.2015, për kalimin e shumës të huamarrësi; kontratë shitjeje nr. (***) , datë 9.2.2019, bashkëngjitur prokura nr. (***) , datë 1.2.2019, certifikata për vërtetim pronësie, kartë identiteti; dokumentin “nxjerrje llogarie” të llogarisë rrjedhëse/llogaria e pagës së bashkëshortit, N. Dh. R., printuar në datën 24.10.2019, bashkëngjitur dokumenti për vërtetimin e numrit të kësaj llogarie; dokumentin “nxjerrje llogarie”, llogaria në “Raiffeisen Bank”, të shoqërisë “B.” sh.p.k., datë 19.3.2019; certifikatë familjare datë 1.2.2019 dhe certifikatë vdekjeje e shtetas L. R., datë 1.2.2019, të lëshuara nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Korçë.

- ✓ Subjekti ka kryer deklaram të mjaftueshëm për sa i përket përdorimit të huas së marrë në shumën 4.000.000 lekë – provohet burimi i ligjshëm i krijimit të shumës së dhënë hua në favor të subjektit dhe bashkëshortit të saj, si dhe përputhen të gjitha deklaramet e subjektit me dokumentacionin e depozituar dhe me veprimet e kryera në mënyrë kronologjike, prej përfitimit të huas e deri në shlyerjen e saj.
- Komisioni shtriu hetimin në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi, midis subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj me shoqërinë “B.” sh.p.k., si dhe me administratorin dhe ortakët e kësaj shoqërie, përkatësisht shtetasit L. B., A. B., I. B. .

4.13 Nga korrespondenca³⁵ e mbajtur me institucionet punëdhënëse të subjektit dhe bashkëshortit nuk është konfirmuar shqyrtimi i ndonjë procesi gjyqësor në favor të kësaj shoqërie apo shtetasve të lartpërmendur.

4.14 Komisioni, gjithashtu, ka pyetur³⁶ edhe subjektin e rivlerësimit i cili ka cituar shprehimisht se: *“Kontrata e huas nr. (***) , datë 3.9.2015, ka pasur si huamarrës bashkëshortin tim N. Dh. R.. Marrëdhënia e tij me administratorin L. B. është një marrëdhënie shoqërore/miqësore e ngushtë dhe e tillë është kjo marrëdhënie edhe me vëllezërit e tij (vëllezërit e L.), shtetasit I. B. dhe A. B.. Gjithashtu, edhe vëllezërit e bashkëshortit tim (R. dhe A. R.) kanë marrëdhënie shoqërore/miqësore me shtetasin L. B.”*

4.15 Njëkohësisht, Komisioni ka kërkuar informacion edhe nga Autoriteti i Prokurimit Publik, nisur nga qëllimi i funksionimit të legjislacionit në këtë fushë në marrëdhënie me autoritetet shtetërore dhe ndonjë preferencë të realizuar në favor të huadhënësit në kohën që bashkëshorti i subjektit ka ushtruar funksionin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, nga ku është konfirmuar se huadhënësi në cilësinë e administratorit të shoqërisë që administron, nuk ka nënshkruar kontrata me institucionin punëdhënës të bashkëshortit të subjektit.

4.16 Në përfundim, nga analizimi i deklarameve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar nga hetimi administrativ, trupi gjykues nuk konstatoi në asnjë rast se subjekti i rivlerësimit apo bashkëshorti i saj janë gjendur në konflikt interesi me huadhënësin, shtetasin L. B., për të mundësuar krijimin e kësaj pasurie dhe legjitimuar burimin e saj.

4.17 Në lidhje me burimin tjetër të kësaj pasurie për shumën 1.000.000 lekë, kursime në “Union Bank”.

4.18 Nga korrespondenca e mbajtur me bankën rezulton se subjekti i rivlerësimit ka llogari page në “Union Bank”. Subjekti, në datën 7.5.2014, ka nënshkruar autorizim për pagesë periodike, ku autorizon bankën për debitimin e shumës 60.000 lekë, çdo muaj në llogarinë e saj të kursimeve. Kjo llogari kursimi deri në datën 4.9.2015 kishte arritur vlerën 1.148.203,36 lekë, shumë të cilën subjekti e ka transferuar në llogarinë rrjedhëse. Nga këto kursime në datën 7.9.2015 është paguar me transaksion bankar vlera prej 1.000.000 lekësh për blerjen e apartamentit.

4.18.1 Njësia e Shërbimit Ligjor, pasi kreu analizën financiare për vitet 2014 – 2015, nga momenti i krijimit të llogarisë së kursimeve dhe investimi në këtë pasuri, konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë në këtë pasuri dhe të krijojë kursime, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

³⁵ Shkresa nr(***)prot., datë 14.11.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresa nr(***)prot., datë 19.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; shkresa nr. (***) prot., datë 21.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; shkresa nr. (***) prot., datë 19.11.2019, e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

³⁶ Referojuni pyetësorit, datë 13.11.2019, në dosjen e Komisionit.

4.18.2 Në lidhje me detyrimin (i përbashkët me bashkëshortin N. R.) ndaj “Raiffeisen Bank”, në bazë të kontratës së kredisë bankare dhe hipotekës me nr. (***) , datë 17.9.2015, kredi e marrë për shumën 5.000.000 lekë.

4.19 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁷.

4.19.1 Komisioni e ka trajtuar këtë kredi në pasurinë nr. (***) , dhe gjatë hetimit nuk i kanë rezultuar problematika.

4.19.2 “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. (***) prot., datë 17.9.2019, konfirmon se shtetasi N. R. ka kredi me gjendje debitore në shumën 4.497.971 lekë, datë 27.1.2017.

- Trupit gjykues, nga analizimi i dokumentacionit, i ka rezultuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.
- Në lidhje me detyrimin ndaj “Raiffeisen Bank”, në llogarinë e shtetasit N. Dh. R., (person i lidhur) bashkëshort i subjektit deklarues, znj. Miliana Sh. Muça, në llogarinë *overdraft*, referuar dokumentit “nxjerrje llogarie”, printuar në datën 20.1.2017, *overdraft* që rezultoi i prekur (tërhequr) dhe i paplotësuar në ditën e dorëzimit të deklaratës, sipas të dhënave që janë nxjerrë nga banka ditën e printimit të këtij dokumenti. Shuma e detyrimit financiar e mbetur pa shlyer është 168.176 lekë.

4.20 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin përkatës³⁸.

4.21 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. (***) prot., datë 17.9.2019, konfirmon se shtetasi N. R. ka llogari page me gjendje debitore në shumën 180.540.67 lekë, në datën 27.1.2017.

- ✓ Trupi gjykues, nga analizimi i dokumentacionit, ka konstatuar se ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar ka ndodhur për shkak të paraqitjes së dokumentacionit bankar në datën 20.1.2017, dhe konfirmimit që i përket datës 27.1.2017.

4.22 Në lidhje me deklarimin e pasurive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. N. Dh. R., vjehrrës së subjektit, znj. L. Ll. R. dhe vjehrrit të subjektit, z. Dh. P. R. .

4.23 Tokë bujqësore marrë me ligjin nr. (***) , në fshatin Z., Njësia Administrative P., e Bashkisë Maliq, sipas dokumentit akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP) me nr. (***) regj., datë 27.2.1995, në emër të kryefamiljarit Dh.R.(babai i subjektit). Sipas këtij akti familja bujqësore ka marrë një sip. prej 14.400 m² tokë bujqësore në 6 parcela në të cilat subjekti ka të drejtën e bashkëpronësisë. Në këtë sipërfaqe janë 14.000 m² tokë bujqësore dhe 400 m² truall në banesë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁹.

4.24 Trupit gjykues, në lidhje me këtë pasuri nga analizimi i dokumentacionit të administruar, i ka rezultuar se familja e origjinës së bashkëshortit të subjektit është trajtuar me ligjin nr. 7501/1991, dhe se sipas certifikatës së gjendjes familjare të datës 1.8.1991, rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë njëri prej anëtarëve të familjes në

³⁷ Vërtetimin datë 20.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”; kontratë kredie bankare dhe hipoteke nr(***) , datë 17.9.2015, (aneks nr. 4/4, në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁸ Nxjerrje e llogarisë së shtetasit N. R., lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, datë 20.1.2017, ku rezultoi se kjo llogari ka gjendje debitore në shumën 168.176 lekë (aneks nr. 4/6, në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁹ Certifikatë pronësie nr. (***) , datë 23.12.2016; certifikatë pronësie nr. (***) , datë 23.12.2016; certifikatë pronësie nr. (***) , datë 23.12.2016; akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), me nr. regjistri (***) , datë 27.2.1995; kontratë shitblerjeje nr(***) , datë 14.7.2000; vërtetim nr. (***)prot., datë 24.10.2016; certifikata e përbërjes familjare, datë 24.10.2016 (aneks nr. 4/7, në dosjen e ILDKPKI-së).

pjesë takuese 1/6, në pasurinë e përfituar sipas këtij ligji dhe po ashtu anëtarë përfitues kanë qenë edhe vjehri dhe vjehra e subjektit të rivlerësimit.

- ✓ Në të tilla kushte, duke qenë se është arsyetuar më gjerësisht dhe ligjërisht në pasurinë e parë të subjektit të rivlerësimit në këtë vendimmarrje, pasi ka deklaruar një pasuri të përfituar me të njëjtin ligj, çmohet të mos përsëriten të njëjtat argumente për këtë pasuri, për sa kohë nuk u vërejtën problematika në përfitimin e saj, si dhe u konstatua se pasuria është deklaruar saktësisht me vërtetësi dhe në përputhje me dokumentet provuese.
- ✓ Në lidhje me kursimet *cash*, me burim të ardhurat nga pensioni i pleqërisë së vjehrit të subjektit deklarues, z. Dh.R., dhe vjehrrës së subjektit deklarues, znj. L. R., (person i lidhur, autorizues) dalë në pension secili që prej vitit 1998, sipas vërtetimit nr. (***) prot., datë 20.1.2017, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë dhe vërtetimit nr. (***) prot., datë 20.1.2017, rezulton se kanë përfituar pension pleqërie për periudhën 1998 – 2017. Vjehri i subjektit, z. Dh. R., në vlerën 2.250.126 lekë dhe vjehra, znj. L. R., në vlerën 1.248.631 lekë, të cilat (së bashku) janë edhe burimi i krijimit të vlerës së kursyer. Vlera: 300.000 lekë. Pjesa takuese: 50/50, së bashku me bashkëshorten, znj. L. R. .

4.25 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁰.

4.26 Në lidhje me gjendjen *cash*, Komisioni, në analizë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti në lidhje me të ardhurat e konfirmuara, konkretisht të vërtetimeve përkatëse të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë, si dhe nisur nga fakti se subjekti ka jetuar së bashku me prindërit e bashkëshortit, ku ekonomia funksionon si një bashkësi dhe se analiza financiare ka rezultuar në çdo vit në balancë pozitive, krijohet bindja e deklaramit të subjektit të rivlerësimit me saktësi dhe vërtetësi lidhur me këto kursime. Gjithashtu, duke qenë se të ardhurat e krijuara nga prindërit e bashkëshortit të subjektit nuk rezultojnë në asnjë rast si burim i krijimit të ndonjë pasurie, depozite apo shlyerje të detyrimeve financiare.

- ✓ Trupi gjykues konkludon se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar, si dhe me mundësinë financiare për të akumuluar gjendjen *cash*.

⁴⁰ Vërtetim nr. (***) prot., datë 20.1.2017, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë; vërtetim nr. (***) prot., datë 20.1.2017, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë (aneks nr. 4/9, në dosjen e ILDKPKI-së).

Analiza financiare e detajuar për periudhën 2003 – 2016

Nr	Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	TË ARDHURA	1 155 441	1 603 664	1 768 384	1 745 681	1 772 838	1 859 955	2 061 835	2 191 850	2 290 927	2 387 369	2 463 938	2 940 803	2 926 467	2 805 273
	Të ardhura nga paga Subjekti	421 941	673 243	781 004	799 247	779 293	734 336	813 345	867 130	933 651	934 600	977 825	1 206 965	1 308 422	1 378 979
	Të ardhura nga paga Bashkëshorti	606 409	786 514	808 249	782 154	802 097	915 577	1 013 714	1 077 004	1 098 154	1 183 831	1 209 025	1 450 319	1 426 156	1 426 294
	Të ardhura nga pensioni Vjehri	83 064	89 964	97 259	110 076	122 460	130 128	142 932	150 402	156 636	161 868	166 847	171 288	115 885	-
	Të ardhura nga pensioni Vjehrra	30 882	35 796	41 253	54 204	68 988	79 914	91 844	97 314	102 486	107 070	110 241	112 231	76 003	-
	Të ardhura nga interesat bankare	13 145	18 147	40 619	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	SHPENZIME	619 320	589 320	817 785	667 785	(1 449 496)	1 356 882	1 429 727	1 758 196	1 424 925	1 598 233	1 209 351	1 299 927	(7 174 215)	1 697 264
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	469 320	469 320	547 785	547 785	683 100	683 100	683 100	683 100	683 100	705 120	705 120	1 099 990	915 794	705 276
	Shpenzime qiraje	120 000	120 000	120 000	120 000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Shpenzime arredimi	30 000	-	150 000	-	220 000	50 000	50 000	-	100 000	50 000	50 000	-	-	-
	Detyrim i mbetur ndaj K.	-	-	-	-	(800 000)	800 000	-	-	-	-	-	-	-	-
	Kredia BKT (principal+interes) 26.000 CHF	-	-	-	-	(1 552 596)	507 769	565 078	665 774	875 865	-	-	-	-	-
	Hua Sh. M. 14.2.2008 (800,000 lekë)	-	-	-	-	-	(700 000)	100 000	100 000	100 000	100 000	300 000	-	-	-
	Hua H. H 14.9.2011 (500,000) leke	-	-	-	-	-	-	-	-	(500 000)	500 000	-	-	-	-
	Kredi RFZ 17.09.2015 (5.000.000 lekë)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	(4 896 362)	621 830
	Hua nga shoqëria B. 3.9.2015	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	(4 000 000)	-
	Shpenzime arsimit shkolla ***	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	126 000	266 000
	Shpenzime për regjistrimin e ap.Tiranë (noteri+hipotekë)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	498 655	-
	Shpenzime TIMS	-	-	-	-	-	16 014	31 549	309 322	165 960	243 113	154 231	199 937	181 698	104 158
3	PASURI	-	717 147	(17 058)	739 001	2 867 654	(61 180)	92 654	(51 992)	101 276	352 790	(39 572)	(13 800)	9 286 969	(69 635)
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme														
	Tokë bujqësore në fshatin Maminas Durrës (1.5 dylm) (1/5)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Tokë bujqësore në Zvirinë, Korçë (9 dylm) (1/4)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Makine benz ***, Bashkëshorti	-	-	551 329	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Apartament me sip.98m2 Korçe 3.8.2008-K. shpk	-	-	-	-	3 800 000	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Apartament me sip.86 m2 + garazh me sip.17.7 m2 Tiranë (04.09.2015) +mobilim	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	10 000 000	-
	Ndryshim Likuiditeti	-	717 147	(568 387)	739 001	(932 346)	(61 180)	92 654	(51 992)	101 276	352 790	(39 572)	(13 800)	(713 031)	(69 635)
	DIFERENCA (1-2-3)	536 121	297 197	967 656	338 895	354 679	564 253	539 455	485 646	764 726	436 346	1 294 159	1 654 676	813 712	1 177 644

II. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës, me nr. (***) prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. (***), datë 31.7.2019, ku ka konstatuar se:

Nga hetimi nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Miliana Muça.

➔ Nga hetimi nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti i vlerësimit profesional është mbështetur në:

Formularin e vetëdeklarimit, tri dokumente ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë Gjyqësor:

- a) Aftësitë profesionale
- b) Aftësitë organizative
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale
- ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Në raport janë përshkruar gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit të subjektit, si dhe dokumentet e depozituara prej tij. Po ashtu, janë përshkruar detyrat e kryera, trajnimet e përfituara, etj. (për më shumë referojuni raportit përkatës). Raporti, ndër të tjera, në analizën e gjetjeve ka konstatuar, si vijon:

- Të dhëna nga burime arkivore të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

- Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, për gjyqtaren Miliana Muça janë paraqitur tri ankesa (dy në vitin 2014 dhe një ankesë në vitin 2015) në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Dy ankesa (një e vitit 2014 dhe një e vitit 2015) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit

gjqësor. Një ankesë e vitit 2014 verifikuar për zvarritje gjykimi është arkivuar me arsyetimin se pretendimet janë të pabazuara.

- Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore për gjyqtaren Miliana Muça, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

- Po ashtu, në raportin e vlerësimit profesional janë pasqyruar vlerësimet në drejtim të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të arsytimit ligjor, të aftësisë për të administruar dosjet, etj.

- Në tërësi, raporti thekson se në funksion të zbatimit të ligjit, gjyqtarja përdor referenca në: (i) jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese rreth qëndrimit se gjatë gjykimit të shkurtuar nuk mund të bëhet një cilësim më i rëndë i faktit, objekt akuze; (ii) jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë mbi aplikimin e gjykimit të shkurtuar, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë mbi legjitimitetin e paditësit në ngritjen e padisë.

- Gjithashtu, në raport është pasqyruar fakti se subjekti i rivlerësimit, znj. Miliana Muça, ka aftësi cilësore në arsyetimin ligjor. Gjatë gjykimit, subjekti identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe zhvillon siç duhet procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve, njohjen për çdo rast me të drejtat dhe detyrimet procedurale, prezantimin e gjykatës, debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në shpalljen e vendimit.

- Po ashtu, raporti ka pasqyruar edhe vlerësimin nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura me short, për të cilat është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën, vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në të pesta dosjet gjyqësore janë përfshirë rregullisht: padia dhe provat e paraqitura nga paditësi në procesin civil apo kërkesa për gjykim për provat përkatëse; vendimi i gjyqtarit për caktimin e seancës së parë përgatitore apo kalimin e çështjes në gjykim; aktet e njoftimit të palëve; kërkesat me shkrim të palëve dhe provat e paraqitura prej tyre; procesverbali përgatitor dhe gjyqësor; si dhe parashtrimet e palëve dhe vendimi gjyqësor. Në rastin e dosjes penale të vëzhguar nuk është paraqitur nga gjykata fashikulli penal, ndërsa nga lista e inventarizimit të akteve rezulton të ketë qenë i përfshirë rregullisht në dosje. Vendimet e ndërmjetme janë fiksuar gjithnjë në procesverbal dhe janë të arsyetuara rregullisht, ku citohet për çdo rast edhe shkaku ligjor.

RIVLERËSIMI PROFESIONAL

Komisionit, sikurse është shprehur edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, nuk i kanë rezultuar problematika lidhur me vlerësimin e subjektit të rivlerësimit për sa i përket etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, integritetit, paanësisë, aftësive personale dhe angazhimit profesional.

- Në tërësi, trupit gjykues nuk i kanë rezultuar problematika në lidhje me shqyrtimin dhe gjykimin nga subjekti i rivlerësimit në të tria dokumentet/vendimet gjyqësore dhe në të pesta dosjet e shortuara.

- Gjithashtu, ka rezultuar se vendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit kanë mbetur në fuqi.

- Për sa i përket vendimit nr. (***) , datë 28.9.2016, që i takonte një çështjeje të ndërthurur midis asaj penale dhe civile, me palë: paditës Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kundër të paditurit Q.T., me person të tretë S.M., me objekt “konfiskimin dhe kalimin në pronësi të shtetit të pasurisë së ndodhur në Peshkopi (e identifikuar)”, për të

cilin kolegji i gjykatës, ku subjekti ka qenë me cilësinë e kryesueses, ka vendosur: pranimin pjesërisht të padisë së prokurorisë, konfiskimin e një sipërfaqeje të konvertuar në përqindje 53.5 % etj., shuarjen e masës së sekuestros të sendeve të luajtshme, përcaktimin e organit për ekzekutimin e këtij vendimi. Subjekti ka depozituar vendimin e formës së prerë, si dhe ka dhënë shpjegime në lidhje me vendimmarrjen e saj dhe ecurinë e procesit gjyqësor.

Ndër të tjera, subjekti ka qartësuar se me vendimin nr. (***) , datë 6.2.2017, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka vendosur prishjen e vendimit të saj dhe kthimin e çështjes për rigjykim me trup gjykues tjetër, me arsyetimin se duhet të thirreshin si palë e interesuar në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, dhe persona të tjerë. Subjekti ka sqaruar se lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes në rigjykim, referuar vendimit nr. (***) , datë 26.12.2007, rezulton të jetë ndjekur e njëjta linjë arsyetimi lidhur me themelin e kërkimeve, sikurse dhe në pjesën arsyetuese të vendimit nr. (***) , datë 28.9.2016 (pjesa IV “arsyetimi i gjykatës” vendim i dhënë nga subjekti i rivlerësimit me cilësinë e kryesueses).

Trupi gjykues, në analizë të vendimmarrjeve, ka konstatuar se nga trupa gjykuese, ku subjekti ka qenë në cilësinë e kryesueses, janë marrë në konsideratë parashikimet e nenit 22, të ligjit nr. (***) , datë 3.12.2009 dhe është zbatuar ky nen, i parë i lidhur me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, i zbatueshëm gjatë një gjykimi të tillë (në kohën e gjykimit).

Po ashtu, trupi gjykues ka konstatuar se janë thirrur në cilësinë e personave të tretë në gjykim, disa shtetas dhe se gjatë rigjyimit të çështjes janë çmuar të thërriten edhe persona të tjerë të tretë, të ndryshëm nga ata që kishte orientuar Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda.

✓ Trupi gjykues, për të gjitha arsyet e lartpërmendura, nisur edhe nga shpjegimet e dhëna nga subjekti, pa cenuar themelin e çështjes gjyqësore, vlerëson se prapësimet e subjektit janë bindëse dhe nuk ndikojnë në vlerësimin profesional të saj.

- Komisionit, në lidhje me pesë⁴¹ dosjet e përzgjedhura me short, i ka rezultuar se në tërësi vendimet e subjektit, dhënë në përfundim të shqyrtimit të çështjeve, kanë mbetur në fuqi.

- Gjithashtu, lidhur me përfundimin e çështjes civile që i përket vendimit nr. (***) , datë 27.11.2013 (renditur si çështja e dytë në pesë dosjet e përzgjedhura me short), pas ankimit të ushtruar dhe më tej për shkak të kompetencës, shqyrtimi i saj ka vijuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, ku subjekti⁴² ka shpjeguar mbi përfundimin e çështjes civile me nr. vendimi (***) , datë 27.11.2013, se me vendimin nr. (***) , datë 14.5.2014, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur deklarin e moskompetencës për shqyrtimin e çështjes civile dhe dërgimin e saj në gjykatën kompetente, në Gjykatën e Apelit Administrative Tiranë.

⁴¹ Çështja penale nr. (***)regj., datë 13.11.2015, përfunduar me vendimin nr. (***) , datë 18.12.2015, vendim i cili ka mbetur në fuqi me gjithë ankimin e ushtruar; çështja civile nr. (***) regj., datë 21.2.2013, përfunduar me vendimin nr. (***) , datë 27.11.2013; çështja civile nr. (***) regj., datë 2.9.2014, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse R.L., kundër palës së paditur Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve, Qarku Korçë, person i tretë : ZVRPP-ja Korçë, Komuna P., me objekt të padisë “pavërtetësi e AMTP-së, duke u ndryshuar emri i paditëses i shënuar gabim në këtë akt”, e përfunduar me vendimin nr. (***) , datë 13.10.2014, vendim i mbetur në fuqi pa u ankimuar; çështja civile nr. (***) regj., datë 10.9.2014, që u përket palëve ndërgjyqëse, paditës P.M., kundër palës së paditur SAMT Korçë, ZVRPP-ja Korçë, person i tretë Komuna Pojan, me objekt të padisë “pavërtetësi e AMTP-së, duke u ndryshuar emri i paditësit të shënuar gabim në këtë akt, e përfunduar me vendimin nr. (***) , datë 22.10.2014, vendim i mbetur në fuqi pa u ankimuar; çështja civile nr. (***) regj., datë 1.10.2013, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës P.O., kundër të paditurit S.Ll., me objekt të padisë “lirim dhe dorëzim sendi në bashkëpronësi”, e përfunduar me vendimin nr. (***) , datë 19.2.2014, vendim i mbetur në fuqi pa u ankimuar.

⁴² Në prapësimet e subjektit, datë 28.1.2020.

- Me vendimin nr. (***), datë 18.2.2015, Gjykata e Apelit Administrativ ka vendosur prishjen e vendimit nr. (***), datë 27.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe dërgimin e çështjes për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

- Me vendimin nr. (***), datë 25.6.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, vendim ky i lënë në fuqi me vendimin nr. (***), datë 27.9.2017, të Gjykatës së Apelit Administrativ.

- Më tej, subjekti ka qartësuar se problematika e kompetencës lëndore të gjykimit të kësaj çështjeje lidhet me fillimin e funksionimit të gjykatave administrative në datën 4.11.2013, në zbatim të ligjit nr. 49/2012 dhe mënyrën e interpretimit të mungesës së dispozitës kalimtare të këtij ligji, që përcakton se cila është gjendja, faza apo shkalla e gjykimit mbi të cilin ky ligj i shtrin efektet, për sa i përket kompetencës së gjykatave administrative. Pra, mbi kompetencën lëndore të gjykatës së zakonshme apo gjykatave administrative të gjykimit të çështjeve me natyrë administrative, por që ishin paraqitur për gjykim (regjistruar padia) në kohë më herët sesa hyrja në fuqi e ligjit nr. 49/2012, datë 4.11.2013.

- Subjekti, po ashtu, ka qartësuar se kompetenca është trajtuar prej saj në vendimin nr. (***), datë 27.11.2013 (f. 2), duke mbajtur qëndrim se pse çështja duhet të vijonte të gjykohej nga gjykata e zakonshme, duke argumentuar se padia ishte depozituar për gjykim përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe se lidhur me këtë problematikë të dalë në praktikën gjyqësore, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 49/2012, ka dalë vendimi unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, pra, në kohë më vonë sesa vendimi nr. (***), datë 27.11.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Sipas vendimit unifikues edhe për gjykimin e çështjeve të rezultuara në gjykim përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012, datë 4.11.2013, kompetente bëheshin gjykatat administrative.

- Pikërisht, mbi këtë vendim unifikues është disponuar nga Gjykata e Apelit Administrativ për prishjen e vendimit nr. (***), datë 27.11.2013, dhe dërgimin e çështjes për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

- ✓ Trupi gjykues në vlerësim të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe në analizim të tyre, krahasuar me përmbajtjet e vendimeve gjyqësore, çmon se argumentet ligjore të prezantuara nga subjekti, qëndrojnë dhe për pasojë nuk konkludohen problematika lidhur me vlerësimin e kriterit profesional në tërësi.

Trupit gjykues, në vijim të rivlerësimit profesional, i ka rezultuar se në tërësi vendimet janë të strukturuar, sipas elementeve të parashikuara në nenin 310, të Kodit të Procedurës Civile: pjesa hyrëse, përshkuese- arsyetuese dhe dispozitivi i gjykatës.

Po ashtu, ka rezultuar se arsyetimet e vendimeve janë të qarta, të kuptueshme, të argumentuara, si dhe është konstatuar se vendimmarrjet janë marrë brenda afateve ligjore.

- Në lidhje me tri⁴³ denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar, si më poshtë vijon:

1. Denoncimi⁴⁴ i përfaqësuesit ligjor z. E. M. për shtetasen M. R., me cilësinë e njëjës prej palëve ndërgjyqëse në aktet e depozituara në denoncim.

Denoncuesi në ankimin e tij ka parashtruar se subjekti i rivlerësimit, me vendimin e saj nr. (***), datë 12.12.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ka shqyrtuar një çështje

⁴³ Nr. (***), prot., datë 22.1.2019; nr. (***), prot., datë 9.5.2019; nr. (***), prot., datë 10.6.2019.

⁴⁴ Nr. (***), prot., datë 22.1.2019.

gjyqësore me të njëjtat palë dhe objekt, për të cilën pretendon se gjykatat ishin shprehur më parë.

- Trupi gjykues, nga hetimi i akteve të depozituara, konkretisht, vendime gjyqësore, ka konstatuar se vendimi i subjektit të rivlerësimit (që i përket palëve ndërgjyqëse, paditës/i kundërpaditur P. M., të paditur/kundërpaditës V. M.) me objekt: detyrimin e të paditurve ta njohin bashkëpronar të 6/10 pjesë të shtëpisë së ndodhur në Korçë, etj.), është lënë në fuqi me vendimin nr. (***) datë 21.1.2010, nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Nga leximi i vendimit gjyqësor nuk rezulton që të jenë parashtruar të njëjtat pretendime sikurse parashtrohen në denoncim se subjekti i rivlerësimit me vendimin e saj është shprehur për një gjë të gjykuar më parë dhe për pasojë vërehet se nga Gjykata e Lartë nuk pasqyrohet arsyetim lidhur me këtë pretendim. Gjithashtu, edhe Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 177, datë 7.10.2016, ka vendosur “moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare”.

- Trupi gjykues edhe në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti⁴⁵ konstaton të njëjtën qasje të pasqyruar lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore civile, duke përfshirë edhe faktin se në këtë çështje sikurse pretendohet nga denoncuesi, gjykata nuk ka qenë përpara institutit të gjësë së gjykuar, që lidhet me plotësimin e kushteve të nenit 451/a/2, të Kodit të Procedurës Civile: të njëjtave palë, të njëjtit shkak ligjor dhe të njëjtin objekt gjykimi.

- ✓ Në të tilla kushte, trupi gjykues çmon se denoncimi nuk përbën fakte dhe rrethana që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

2. Denoncimi⁴⁶ i shtetasit V. Ç.

Denoncimi është përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Nga aktet e përcjella nuk konstatohen vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit dhe as ankesa konkrete ndaj saj.

- ✓ Komisioni, në të tilla kushte, konstaton se denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

3. Denoncimi⁴⁷ i shtetasit Y. P.

Denoncuesi informon se subjekti i rivlerësimit, për pasurinë e blerë në Tiranë, ka kërkuar hua tek vëllai i bashkëshortit, shtetasi F. R., në shumën 50.000 apo 60.000 euro. Në këtë kontekst kërkohet që të verifikohet mundësia e dhënies së kësaj shume, pasi denoncuesi bën me dije se shtetasi B. R. është në pamundësi të dhënies hua të kësaj shume, për shkak të falimentimit të biznesit të tij. Po ashtu, denoncuesi informon se subjekti i rivlerësimit nuk është realist në të ardhurat e deklaruara, si dhe në shpenzimet e bëra dhe për të arritur në këtë konstatim, shprehet denoncuesi, mjafton që nga Komisioni të verifikohen shpenzimet për shkollimin e vajzës së subjektit.

Komisioni, gjatë hetimit administrativ, në asnjë rast dhe për asnjërën prej pasurive të deklaruara, nuk ka konstatuar që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar hua të marrë vëllait të bashkëshortit, shtetasit B. R. .

Ndërsa, për sa i përket informacionit tjetër për të verifikuar shpenzimet e shkollimit të vajzës së subjektit, Komisioni përveç përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësorët⁴⁸ përkatës, ka kërkuar⁴⁹ nga institucioni arsimor shkolla jopublike “(***)”, të informojë mbi të gjithë

⁴⁵ Në prapësimet e subjektit, datë 28.1.2020.

⁴⁶ Nr(***)prot., datë 9.5.2019.

⁴⁷ Nr. (***) prot., datë 10.6.2019.

⁴⁸ Referojuni përgjigjes së dhënë në pyetësorin nr. 1, datë 22.1.2019, në dosjen e Komisionit.

⁴⁹ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 22.11.2019, në dosjen e Komisionit dhe përgjigjes nr. (***)prot., datë 25.11.2019, të institutit arsimor jopublik “(***)”, në dosjen e Komisionit.

pagesat e kryera për shkollimin e vajzës së subjektit të rivlerësimit, prej fillimit të studimit në këtë institucion arsimor e deri aktualisht.

Nga verifikimi i të dhënave të këtij institucioni rezulton se çdo informacion financiar lidhur me shpenzimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, në favor të vajzës së saj lidhur me shkollimin, rezulton se përputhet me deklarin e bërë nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe njëkohësisht të gjitha të dhënat financiare janë përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, si shpenzime të kryera pas të cilave kanë rezultuar edhe konstatimet e mësipërme në rezultatet e hetimit administrativ.

Gjithashtu, subjekti në shpjegimet⁵⁰ e saj ka deklaruar se asnjëherë nuk ka pasur një marrëdhënie kontraktore huaje ndërmjet tyre, duke e mbështetur deklarin e saj në deklaratën noteriale nr. (***) datë 24.1.2020, të shtetasit R. R., të depozituar në Komision, ku konfirmohet mungesa e një marrëdhënieje të tillë detyrimi.

Po ashtu, sikurse i ka rezultuar edhe Komisionit, lidhur me vlerën e pagesës së shkollimit të vajzës, subjekti ka ritheksuar se është deklaruar saktësisht në deklaratat vjetore përkatëse dhe në përgjigjet e pyetësorit standard, si dhe është konfirmuar edhe nga përgjigjja e institucionit arsimor me shkresën nr. (***) prot., datë 25.11.2019. Në mbështetje të deklarimeve subjekti ka depozituar edhe 43 kopje të mandateve (shtator 2015 – janar 2020), me të cilat është pajisur nga institucioni shkollor në momentin e kryerjes së pagesave mujore.

Të gjitha shpjegimet dhe provat e depozituara hedhin dritë mbi mosekzistencën e denoncimit të paraqitur.

- ✓ Trupi gjykues, në të tilla kushte, çmon se informacioni i denoncuesit nuk provohet dhe për pasojë nuk merr vlerë në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 84/2016.

- Nga shqyrtimi i parashtrimeve në denoncime, si dhe nga dokumentacioni i administruar, u vërejt se nuk kanë rezultuar shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme, apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.

Për të gjitha shkaqet dhe arsyet e sipërpërmendura, trupi gjykues, pas rivlerësimit të raportit të Grupit të Punës, fakteve publike, denoncimeve, nuk gjeti *indicie*, apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale dhe pas rekomandimit të relatores së çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se:

- Lidhur me kontrollin e pasurisë nën hetimin e thelluar, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar me vërtetësi dhe saktësi deklaratën “Vetting” dhe ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në përputhshmëri me deklarinet periodike, si dhe të mbështetura në dokumentacionin ligjor që në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” në ILDKPKI, sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016.

⁵⁰ Në prapësimet e subjektit, datë 28.1.2020.

- Për kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues, në konsideratë të verifikimit e konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmëri në detyrë edhe pas hetimit të Komisionit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Miliana Muça, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Për kontrollin profesional, trupi gjykues, referuar Aneksit të Kushtetutës (neni E), ligjit nr. 84/2016 (kreu VI), vlerëson se subjekti ka përmbushur kushtet ligjore të pikës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Miliana Muça, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 4.2.2020.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Firdes Shuli

Kryesuese

Olsi Komici

Anëtar

Brunilda Bekteshi

Relatore

*Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta*